




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI
PËR ÇËSHTJET VENDORE



Tetor 2016

2015-2020

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR
DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN
VENDORE

Raporti i Monitorimit Për Periudhën Korrik 2015 – Gusht 2016

Ky raport u përgatit me asistencën e Programit për Zhvillim Vendor dhe Decentralizim (DLDP) mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo qëndrimet e DLDP apo Qeverisë Zvicerane.




TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESAT	4
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. HYRJE	8
3. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM MBI ECURINË E ZBATIMIT TË STRATEGJISË	10
4. ECURIA E ZBATIMIT TË STRAGJISË SIPAS SECILIT QËLLIM STRATEGJIK	12
4.1 Progresi i arritur në drejtim të Rritjes së efikasitetit në tërësi të strukturave të qeverisjes vendore	12
Objektivi strategjik: Reforma administrative – territoriale	12
Objektivi strategjik: Strukturat e Qeverisjes Vendore.....	16
Objektivi Strategjik: Strukurat e dekoncentruara	18
4.2 Progresi i arritur në drejtim të Forcimit të Financave Vendore dhe Rritja e Autonomise Fiskale	18
Objektivi strategjik: Reformimi i sistemit të të ardhurave vendore.....	19
Objektivi Strategjik: Përmirësimi i menaxhimit financiar në nivelin vendor.....	19
4.3 Progresi i arritur në drejtim të Nxitjes së Zhvillimit të Qëndrueshëm Vendor	22
Objektivi Strategjik: Funkcionet e qeverisë vendore	23
4.4 Progresi i arritur në drejtim të Forcimit të Qeverisjes së Mirë në Nivelin Vendor dhe Zbatimit të të Drejtave të Qytetarëve	34
Objektivi Strategjik: Zhvillimi i kapaciteteve të njësisve të qeverisjes,.....	35
Objektivi Strategjik: Sigurimi i një qeverisje të hapur, rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe shtrirjes më të madhe të e-qeverisjes në nivelin vendor.....	38
Objektivi Strategjik : Integrimi Evropian dhe qeverisja vendore.....	42
5. AKTIVITETET KRYESORE DERI NË FUND TË VITIT 2016	43
6. METODOLOGJIA E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	45
7. STATUSI I ZBATIMIT SIPAS AKTIVITETEVE TE PARASHIKUARA NE PLANIN E VEPRIMIT 2015-2020	48

SHKURTESAT


AZRT	Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale
BE	Bashkimi European
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DLDP	Decentralization and Local Development Programme Programi për Zhvillim Vendor dhe Decentralizim
E-PAV	Regjistri Elektronik per Administratës e Pushtetit Vendor
FZHR	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
KiE	Këshilli i Europës
ICT	Information Communitation Technology
IFTH	Sistemi i Informacionit Financiar te Thesarit
IT	Information Technology
IOSSH	Integrated One Stop Shop (Zyra e Integruar me Një Ndalesë)
NjA	Njësi Administrative
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
MBNJ	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
MIAP	Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike
MCV	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PLGP	Projekti për Qeverisjen Lokale/USAID
PPV	Programet e Përgjithsme Vendore
QQ	Qeverisja Qëndrore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNT	Vlerësimi i Nevojave të Trajnimit
RAT	Reforma Administrative Territoriale
SECO	Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (Zvicër)
STAR	Projekti “ Support to Territorial Administrative Reform”
SHAP	Shkolla e Administratës Publike
SKNDQV	Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

1. Përmbledhje Ekzekutive



Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SKNDQV) 2015-2020¹, u miratua në muajin Korrik 2015, dhe ka mbyllur vitin e parë të zbatimit të saj. Strategjia ka ardhur në një moment që bën të mundur thellimin e procesit të decentralizimit dhe konsolidimin e Reformës Administrative Territoriale. Ky raport monitorimi paraqet ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë, i cili përcakton aktivitetet konkrete që duhet të realizohen në 5 vitet e ardhshme, që nga koha e aprovimit të dokumentit të strategjisë, Korrik 2015. Raporti nuk përfshin raportimin e arritjeve të treguesve të monitorimit e vlerësimit, matja e të cilëve do të realizohet në vitin 2017, periudhë që përkon dhe me monitorimin e arritjes të synimeve afatmesme.

Ecuria e zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në strategji është në nivele të kënaqëshme. Aktualisht, kanë filluar rreth 61% e aktiviteteve, nga 69% të parashikuara të fillonin në vitin e parë të zbatimit të strategjisë. Shkalla e realizimit të aktiviteteve në vitin e parë është në masën 42%.



Numri i Aktiviteteve	
Të realizuara	62
Në zbatim	30
Nuk kanë nisur të zbatohen	35
Fillojnë pas 2016-ës	19

Grafiku 1: Shkalla e zbatimit të Planit të Veprimit në %

Nga 4 qëllimet strategjike, apo fushat e politikave të strategjisë, gjatë vitit të parë progres më i mirë paraqitet në aktivitetet që do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit të parë, që lidhet me rritjen e efikasitetit të strukturave të qeverisjes vendore. Kjo është edhe fusha e strategjisë e cila ka numrin më të madh të aktiviteteve të realizuara në këtë vit të parë, 17 aktivitete, ose rreth 59% janë realizuar tashmë. Progres më i ngadaltë vihet re në realizimin e aktiviteteve që lidhen me qëllimin strategjik të forcimit të financave vendore dhe rritjes së autonomisë fiskale, ku vetëm 7 nga 26 aktivitetet e parashikuara janë realizuar, ose në masën 27%.

Rezultatet Kryesore të arritura në vitin e parë të zbatimit të Strategjisë janë në fushën e zhvillimit institucional. Gjatë këtij viti u realizuan disa aktivitete shumë të rëndësishme që janë përcaktuar si arritjet e pritshme të fazës së parë të zbatimit të strategjisë:

1. Strategjia u hartua me mbështetjen e projektit PLGP të financuar nga USAID



- ▲ Ligji i ri për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore“;
- ▲ Ligji i ri për Prefektin
- ▲ Ndryshimet ligjore në Ligjin e Zjarrëfiksive
- ▲ Ligji për Pyjet dhe Kullotat dhe aktet nën ligjore për transferimin e pyjeve
- ▲ Aktet nën-ligjore për transferimin e ujsësjellsave
- ▲ U hartua dhe po zbatohet programi një-vjeçar i trajnimit për certifikimin e nëpunësve civil të njësive të qeverisjes vendore (në fushën e menaxhimit të financave publike dhe në fushën e menaxhimit të mbetjeve);
- ▲ Janë përcaktuar kufijtë administrative të 61 Bashkive të reja.
- ▲ U sigurua mbështetja institucionale për periudhën e tranzicionit pas reformës territoriale për njësitë e reja vendore;
- ▲ U hartua dhe po zbatohet modeli i ri i organigramave të bashkive;
- ▲ U ngrit dhe u vu në funksionim Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale, e cila po asiston me sukses bashkitë e reja;
- ▲ U hartua formula e re për ndarjen e grantit të pakushtëzuar;
- ▲ U transferuan 6 funksione të reja nga pushteti qendror në atë vendor;
- ▲ U miratua Strategjia për Strehimin Social
- ▲ Pjesëmarrja e femrave në këshillat vendorë u rrit nga 12.3% në zgjedhjet vendorë të vitit 2011 në 34.8% në zgjedhjet e vitit 2015. Ndërsa % e femrave në pozicionin e kryesimit të Bashkive u rrit nga 1% në 15% në zgjedhjet vendorë të vitit 2015.


Treguesit e planifikuar të të ardhurave dhe shpenzimeve për pushtetin vendor u rritën ndjeshëm në vitin 2016. Pësha specifike e të ardhurave të planifikuara për pushtetin vendor kundrejt PBB arriti në 1.1% duke u rritur me 0.3% në buxhetin e vitit 2016 kundrejt vitit 2013 dhe më 0.2% ndaj vitit 2015. Ndërsa shpenzimet për qeverisjen vendore u planifikuan në nivelin 3.2% të PBB me një rritje në vitin 2016 prej 0.4% kundrejt vitit 2015 dhe 1% më shumë kundrejt nivelit të shpenzimeve për PV të realizuara në vitin 2013.


Janë në fazën e realizimit dhe pritet të përfundojnë gjatë vitit 2016 një sërë aktivitete që lidhen me zbatimin e funksioneve të veta të NjQV. **Po realizohet rishikimi funksional i sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, po hartohet legjislacioni në fushën e shërbimeve sociale dhe përkujdesit shoqëror; ligji i strehimit social.**

Ende nuk ka progres të dukshëm në lidhje me **ngritjen e kadastrës fiskale.**

Zbatimi i mëtëjshëm i sukseshëm i Strategjisë nxjerr përpara edhe disa sfida të rëndësishme të cilat duhet të adresohen më kujdes në të ardhmen:

- ▲ *Menaxhimi më eficient i financave vendore:* forcimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore të administratës vendore për planifikimin e burimeve njerëzore dhe përparësimin e buxhetit afat-mesëm (PBA), sigurimin e menaxhimit financiar transparent dhe efektiv dhe mirëadministrimin e të ardhurave vendore.
- ▲ *Zgjidhja e problemit të borxheve të trashëguar nëpërmjet marrjes së masave afatmesme dhe hartimit të planeve të menaxhimit të borxheve në perspektive.*
- ▲ *Zbatimi efektiv i Ligjit të Shërbimit Civil:* Krijimi i një administrate vendore të depolitizuar, të paanshme dhe profesionalisht të aftë për të siguruar mirëqeverisjen vendore dhe ofrimin efektiv dhe cilësor të shërbimeve publike për qytetarët.
- ▲ *Zhvillimi i mëtëjshëm i kapaciteteve teknike dhe njerëzore* për njësitë e reja organizative të krijuara në nivel Bashkie për zbatimin e funksioneve të transferuara pranë tyre.

- 
- ▲ *Zhvillimi i aftësive teknike të punonjësve vendorë për hartimin e projekteve të reja që do të mundësojnë financimet nga Qeveria Qëndrore dhe fonde të donatorëve dhe veçanërisht nga programet IPA CBC.*
 - ▲ *Përmirësimi i cilësisë dhe infrastrukturës: në bazë të standardeve minimale kombëtare që duhet të hartohen për gjithë shërbimet dhe që do të jenë të detyruara për tu respektuar nga gjithë Bashkitë*
 - ▲ *Zbatimin koherent i funksionit të decentralizuar për institucionet e edukimit parashkollor dhe arsimin parauniversitar, koordinim më i mirë midis MeF dhe MAS lidhur me planifikimin më të mirë të burimeve njërëzore e fondeve të nevojshme.*
 - ▲ *Zhvillimi dhe funksionimi i mekanizmave të monitorimit nga strukturat komunitare mbi rolin e Këshillave Bashkiake lidhur me planifikimin e fondeve (buxhetit të Bashkisë), vendosjen e prioriteteve për investime që të sigurojë një zhvillim të balancuar të njësive administrative përbërëse si dhe transparencë në ekzekutimin e buxhetit vendor të orientuar sipas rezultateve.*
 - ▲ *Rritja e bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe komunitetit të biznesit: ndërrmarja e projekteve të përbashkëta nëpërmjet iniciativave të financuara bazuar në partneritetin –publik-privat.*
 - ▲ *Rritja e transparencës dhe informimit të publikut: Zbatimi i plotë nga Bashkitë i detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".*
 - ▲ *Përfundimi i Planeve të Përgjithshme Vendorë - vazhdimi i mbështetjes për hartimin e planeve të mbetura brënda vitit 2017.*
 - ▲ *Konsolidimi i sistemit të trajnimit dhe financimit të tij = sigurimi i një sistemi të konsoliduar për trajnimin e administratës vendorë dhe këshilltareve vendorë, dhe gjetja e burimeve të financimit nëpërmjet zbatimit të skemave të qëndrueshme të financimit të programit të trajnimit.*
 - ▲ *Këshilli Konsultativ: Ngritja dhe funksionimi i plotë i Këshillit Konsultativ si instrumenti kryesor për koordinimin institucional dhe monitorimin e zbatimit të reformave të decentralizimit e vetë strategjisë.*




2. Hyrje

Vizioni i Qeverisë i prezantuar në Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 është: *"Fuqizimi i qeverisjes vendore dhe i procesit të decentralizimit me qëllim që të sigurohet një efikasitet më i lartë i vetë qeverisë vendore dhe rritje e autonomisë financiare dhe funksionale."* Ky vizioni ndjek parimet dhe standardet e përcaktuara në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe parimet e Hapësirës Administrative Evropiane për qeverisjen vendore.

Për arritjen e këtij vizioni gjatë periudhës 2015-2020 strategjia ka përcaktuar edhe prioritetet kryesore të Qeverisë të cilat janë:

- (i) përfundimi i reformës administrative-territoriale;**
- (ii) përmirësimi i procesit të decentralizimit të financimit publik;**
- (iii) rritja e cilësisë dhe përmirësimi i shërbimeve publike të siguruara nga qeveria vendore, në bazë të standardeve evropiane, duke ju përgjigjur të drejtave dhe nevojave të qytetarëve;**
- (iv) rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së qeverisë vendore;**
- (v) rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve, në veçanti, e grave dhe sigurimi adekuat i interesave të tyre si dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e vendimmarrjes së qeverisjes vendore.**

Qëllimet strategjike kryesore të reformës së ardhshme të decentralizimit dhe qeverisjes vendore, si edhe të përparësive të politikave do të jenë si më poshtë. Çdo qëllim strategjik do të arrihet nëpërmjet plotësimit të objektivave strategjike dhe objektivave specifike, sic paraqiten në skemën e mëposhtme për një periudhë 6 vjecare, të ndara në tre faza:



Faza e parë: afatshkurtër (2015-2016): përfshin disa veprime dhe masa të menjëhershme, të cilat është e mundur të arrihen në një afat të shkurtër. Fokusi kryesor i reformave në këtë fazë është vendosur në rishikimin e të gjithë kuadrit ligjor ekzistues, veçanërisht të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore, si dhe miratimit të Ligjit për Financat Vendore. Kjo fazë përfshin edhe 16 veprime kyç prioritare si të natyrës legislative ashtu dhe të aspektit institucional.²


Faza e dytë – afatmesme (2017 deri 2018)

Në këtë fazë do të trajtohen çështje të rëndësishme që lidhen me zbatimin e reformës së re territoriale-administrative dhe konsolidimin e njësisve të reja vendore dhe konsolidimin e kapaciteteve të qeverisjes vendore.³

Faza e tretë – afatgjatë (2019 deri 2020)

Politikat dhe veprimet në këtë fazë do të orientohen nga zbatimi i kuadrit ligjor dhe reformave të hartuara në fazat e mëparshme dhe rishikimit afatmesëm që do ti bëhet strategjisë. Në këtë fazë veprimet do të kenë përmbushjen dhe verifikimin e qëllimit final të strategjisë për rritjen e efikasitetit në nivel vendor dhe fuqizimin e qeverisjes vendore.

Dukë konsideruar reformën territoriale si një ndër prioritetet kryesore të kësaj strategjie, masat e parashikuara në strategji në këto 6 vjet parashikojnë një proces të fillimit të zbatimit të saj në vitet e para, duke shkuar drejt procesit të konsolidimit të plotë në vitet e fundit të zbatimit të saj.



Plani i Veprimit 2015-2020 përfshin 146 aktivitete në total të cilat do të kontribuojnë në arritjen e 7 objektivave strategjike, të grupuara sipas 4 qëllimeve strategjike.

2. Këto masa kryesore janë:

- Miratimi i një sërë ligjesh si: Ligji i ri për Vetëqeverisjen dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore; Ligji i ri për Financat e Qeverisjes Vendore; Formula e re për ndarjen e grantit të pakushtëzuar; Rishikimi i ligjit për prefektin/prefekten; Rishikimi i legjislacionit në fushën e shërbimeve sociale dhe për kujdesit shoqëror; Rishikimi i ligjit të strehimit social; Rishikimi i legjislacionit për taksën e pasurisë dhe ngritja e kadastrës fiskale; Rishikimi i ligjit për shërbimin zjarrfikës;


- Masa të zhvillimit institucional: Modeli i ri i organigramave të bashkive; Plani kombëtar Afatmesëm për Trajnimin e NJQV-ve; Programi i trajnimit për njësitë e qeverisjes vendore; Ngritja dhe funksionimi i Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale; Rishikimi funksional i sektorit të ujësjellës-kanalizimeve; Ngritja e kapaciteteve për aplikimin e projekteve të financuara nga BE-ja; Mbështetja institucionale dhe infrastrukturale për periudhën e tranzicionit pas reformës territoriale; Mbështetja për kapacitetet vendore në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.

3. Masat kryesore të planifikuara për këtë fazë janë: Funksionalizimi i zyrave unike të shërbimit (one stop shop) në të gjitha njësitë administrative; Mbështetja për administratën tatimore në nivel vendor; Mbështetja për funksionimin e këshillave të bashkive; Harmonizimi i politikave të zhvillimit rajonal dhe lokal; Programi për standardet minimale për shërbimet publike në nivel vendor; Monitorimi i qeverisjes vendore mbi bazë performancën e shërbimeve publike; Planet vendore të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave; Programi i trajnimit për njësitë e qeverisjes vendore; Kalimi i kompetencave për shërbimin e mbrojtjes kundra zjarrit; Konsolidimi i funksionimit për ujitjen dhe kullimin; Konsolidimi i funksionit të mirëmbajtjes së rrugëve urbane dhe rurale; Transporti publik.


3. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM MBI ECURINË E ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SKNDQV) 2015-2020, shoqërohet nga një plan veprimi, i cili përmban aktivitete të mirëpërcaktuara dhe tregues respektivë të matjes së suksesit. Plani i veprimit përfshin 146 aktivitete të konkretizuar në arritjen e rreth 260 treguesve të rezultatit (produkteve) që masin edhe realizimin e tyre. Shpërndarja e aktiviteteve sipas kohës së fillimit të tyre, në përputhje edhe më tre fazat e realizimit të strategjisë, paraqitet si vijon:


Grafiku 2: Numri aktivitete sipas vitit të fillimit të zbatimit



Grafiku 3: Peshat specifike sipas viteve



Siç paraqitet nga grafiku 3 më sipër, rreth 69% e aktiviteteve parashikohet të fillonin në vitin e parë të zbatimit të strategjisë (95 ose 66% e aktiviteteve parashikohet të nisnin në vitin 2015 dhe 4 ose 3% në vitin 2016). Aktualisht ka pasur një ecuri më të mirë në drejtim të fillimit të zbatimit të aktiviteteve, duke marrë parasysh parashikimet e planit të veprimit.




Numri i Aktiviteteve	
Të realizuara	62
Në zbatim	30
Nuk kanë nisur të zbatohen	35
Fillojnë pas 2016-ës	19

Grafiku 4: Shkalla e zbatimit të Planit të Veprimit në %


92 aktivitete ose 63% e totalit të aktiviteteve të planit të veprimit kanë filluar të zbatohen në vitin e parë të zbatimit të strategjisë, nga të cilat 62 aktivitete ose 42% e totalit të aktiviteteve, janë realizuar, 35 aktivitete, ose 24% e totalit do të fillojnë pas vitit 2016, ndërsa 19 aktivitete, të cilat duhet të fillonin në periudhën 2015-2016 ende nuk kanë nisur të zbatohen. Duhet përmendur se po kaç aktivitete, të cilat ishin planifikuar të fillonin pas vitit 2016 kanë filluar të zbatohen që në këtë periudhë.

Në nivel prioritetesh, progresi më i mirë paraqitet në shtyllën e katërt, që lidhet më forcimin e qeverisjes së mire, e cila ka edhe numrin më të madh të aktiviteteve që kanë filluar të zbatohen në këtë vit të parë, kurse më mbrapa paraqitet shtylla e dytë, (qëllimi strategjik 2) që lidhet më reformat në financat vendore .

Grafiku 5: Statusi i zbatimit të aktiviteteve – në numër aktivitete



Grafiku 6 : Statusi i zbatimit të aktiviteteve sipas secilit prioritet në %



Siç shihet nga grafikët 5 dhe 6 më lart, progresi më i mirë është bërë në prioritetin e parë, ku dhe numri i aktiviteteve të realizuara është 24 ose baraz me 83% të aktiviteteve, i ndjekur nga prioriteti i tretë me një numër për 24 aktivitete të realizuara ose 67% e totalit. Progres më i ngadaltë vihet re në prioritetin e dytë, i cili edhe pse ka një numër më të vogël aktivitete të parashikuara, mbetet në nivele të ulëta të realizimit të aktiviteteve, vetëm 11 aktivitete, ose 42% e totalit.

4. ECURIA E ZBATIMIT TË STRAGJISË SIPAS SECILIT QËLLIM STRATEGJIK

Në vijim jepet një analizë më e detajuar e aktiviteteve sipas secilës nga shtyllat apo qëllimet strategjike të Strategjisë.

4.1 Progresi i arritur në drejtim të Rritjes së efikasitetit në tërësi të strukturave të qeverisjes vendore


Në kuadër të këtij qëllimi strategjik plani i veprimit parashikon realizimin e 29 aktiviteteve, të cilat do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike të: reformës administrativo-territoriale, strukturave të Qeverisjes Vendore dhe strukturave të dekoncentruara.

Situata e zbatimit të aktiviteteve brenda këtij prioriteti paraqitet si vijon:

Grafiku 7: Statusi i zbatimit të aktiviteteve në total (në %)



Grafiku 8: Statusi i Zbatimit të Aktiviteteve për secilin objektiv strategjik (në numër)



Siç shihet nga grafikët e mësipërm, pjesa më e madhe e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të këtij qëllimi strategjik, 17 aktivitete ndaj 29 në total ose 59% janë realizuar tashmë. Vetëm 4 aktivitete të cilat ishin parashikuar të fillonin në periudhën 2015-2016 ende nuk kanë filluar. Këto aktivitete lidhen me objektivin e dytë të mbështetjes institucionale për bashkitë e reja.

Objektivi strategjik: Reforma administrative - territoriale

Konsolidimi administrativ dhe financiar

Pas miratimit të hartës së re administrative filloi procesi i konsolidimit administrativ i njësive të mëparshme dhe krijimi i njësive të reja. Me qëllim realizimin e këtij procesi, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 510 datë 10 Qershor 2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial⁴ me asistencën e projektit STAR u hartuan 373 raporte financiare të NJQV, duke i konsoliduar këto raporte në 61 bashkitë e reja.

Raportet financiare janë vënë në dispozicion të bashkive të reja, si dhe janë diskutuar me Bankën Botërore dhe Fondin Ndërkombëtar Monetar. Bashkitë duhet të marrin masat për adresimin e rekomandimeve përkatëse.⁵

NJQV-të e reja tashmë mbajnë përgjegjësi të plotë për menaxhimin e burimeve njerëzore, të kapitalit dhe atyre financiare brenda territoreve të tyre. Problematika që duhet të adresohet prej tyre është zgjidhja e problemit të detyrimeve të prapambetura, të cilat financiarisht mbarten në administratat e reja. Zgjidhja e çështjeve të borxheve do të mund të bëhet nëpërmjet marrjes së masave afatmesme dhe hartimit të planeve të menaxhimit të borxheve në perspektive.

Hapi tjetër i lidhur me konsolidimin administrativ është dhe përcaktimi gjeografik i kufijve administrativë të 61 bashkive. Aktualisht është hartuar draft VKM për përcaktimin e kufijve, i cili pritet së shpejti të kalojë për aprovim në Këshillin e Ministrave. Në këtë kontekst, 120 specialistë nga 61 NJQV janë trajnuar në përdorimin e sistemit të vendosur GIS për bashkitë e tyre përkatëse.

Një arritje e rëndësishme në kuadër të Objektivit strategjik "Reforma administrativo-territoriale" është funksionimi i plotë i **Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT).**⁷ **AZRT-ja ka si mision dhënien e ndihmës për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor,** në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale dhe mbështetjes administrative deri në arritjen e funksionalitetit të plotë të 61 bashkive të reja. Aktualisht personeli i AZRT-se përbëhet nga 14 persona. Gjatë vitit të parë të funksionimit të saj AZRT ka kryer aktivitete të shumta në gjithë vendin në lidhje me funksionet e reja (ujitje, kullim, zjarrëfikse, pyje dhe kullota, arsim, etj.), ku kanë marrë pjesë rreth 800 persona, përfaqësues të bashkive të ndryshme.

Në kuadër të Programit të mbështetjes infrastrukturore Financime të konsiderueshme të projekteve nëpërmjet programeve të ndryshme janë financuar nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, për vitet 2014-2015-2016. Në total financimi nga FZHR ka qënë në masën prej 47 miliard lekë

Sektorët	Financimi në lekë	% e Financimit për secilin sektor
Arsimi	6,448,918,619	13.8%
Art dhe kulturë	294,637,068	0.6%
Infrastruktura vendore dhe rajonale	38,907,337,031	83.3%
Mjedis dhe pyllëzim	170,000,000	0.4%
Shëndetësia	137,078,529	0.3%
Shqipëria Dixhitale	294,637,068	0.6%
Ujësjellës - Kanalizime	439,092,740	0.9%

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme pjesa më e madhe e financimeve është përqëndruar në përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës urbane e rajonale ndjekur nga financimi i programeve në zhvillimin e infrastrukturës së arsimit. Në përmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit për periudhen 2015-2016 është bërë e mundur të kryhen investime në rrugë dhe rikonstruksione të autostradave, sisteme të ujësjelles dhe kanalizime, parqe publike dhe ndërhyrje të tjera.


Bashkitë e reja po mbështeten në drejtim të aplikimit të shërbimeve të integruara administrative nëpërmjet aplikimit të teknologjisë së informacionit si për 61 bashkitë dhe njesitë administrative. Aktualisht janë pilotuar mënyrat e ofrimit të shërbimeve përmes teknologjisë së informacionit në 9 Bashki (Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lushnjë, Berat dhe Kuçovë. Nga lista e identifikuar fillimisht e shërbimeve unike të qeverisjes vendore me 67

4. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/103-2015.pdf

5. Fq 119

6. Qëllimi kryesor i strategjisë nën këtë objektiv është rritja e efikasitetit të administratës vendore, cilësisë dhe standardeve të ofrimit të shërbimeve, si dhe zhvillimi i drejtë i territorit, duke mundësuar burime më të mëdha njerëzore dhe financiare, duke shtuar përgjegjësitë dhe kompetencat në nivel lokal dhe duke u orientuar drejt një vendimmarrjeje më transparente dhe me më shumë pjesëmarrje.

7. Miratimi i AZRT- së u bë në tremujorin e parë të vitit 2015 me VKM Nr. 83, datë 28.1.2015. "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale" dhe VKM Nr. 235, datë 18.3.2015 "Për një shtesë në numrin e punonjësve dhe të fondeve buxhetore për Agjencinë e Zbatimit të Reformës Territoriale, për vitin 2015".



shërbime, të cilat janë dixhitalizuar, numri i shërbimeve të dixhitalizuara është rritur në 83, të cilat janë zbatuar në Bashki të ndryshme sipas veçorive përkatëse : Në Bashkinë Shkodër (aktualisht janë dixhitalizuar 72 shërbime në bashki dhe 2 njësi administrative), Bashkinë Lezhë (aktualisht janë dixhitalizuar 83 shërbime në bashki dhe 2 NJA) dhe Bashkinë Vau i Dejës (aktualisht janë dixhitalizuar 62 shërbime në Bashki dhe 1 NJA). Është hartuar një model rregullore, si dhe janë zhvilluar rregulloret e procedurave administrative për përdorim në sistemin e Zyrave të Integruara me Një ndalesë në Lezhë, Shkodër, dhe Vau i Dejës. Asistenca do të vazhdojë në vitet në vijim nëpërmjet trajnimeve tematike.

Ka vazhduar me sukses puna për mbështetjen institucionale për bashkitë e reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015. Është ofruar asistencë teknike për administratorët e qytetit (menaxheri i qytetit) dhe administratorët lokalë. Me mbështetjen e OSBE-së në Tetor 2015 është bërë një Trajnim Hyrës me 323 administratorët e rinj, nëpërmjet 6 takimeve rajonale.

Ka vijuar puna me hartimin e Planeve Vendore të Zhvillimit të Territorit Është ofruar mbështetje për Bashkitë e reja për harmonizimin e Planeve të Zhvillimit të Territorit sipas ndarjes së re administrative: Nga AKPT u hartua Udhëzuesi për Hartimin e Planeve të Zhvillimit të Territorit. MZHU-ja ka financuar hartimin e 26 planeve të përgjithshme vendore të harmonizuara të bashkive ndërsa 10 plane janë financuar dhe mbështetur nga projektet PLGP/USAID dhe DLDP⁸. MZHU-ja dhe MSHÇV do të shikojë mundësitë në periudhën 2017-2018 e hartimit të planeve të përgjithshme vendore në 25 Bashkitë e tjera. Ka filluar procesi i hartimit të PPV-ve në Bashkitë e Matit dhe Tropojës dhe brenda vitit 2016 do të nisë procesi për hartimin e PPV të Bashkive Klos dhe Vau i Dejës.

Vemendje i është kushtuar ngritjes së kapaciteve të bashkive për të siguruar lidhjen e PPVve me procesin e Programimit Buxhetor Afatmesëm. Bazuar në metodologjinë e hartuar nga Programi DLDP, janë mbajtur trajnime dhe do të mbahen në muajt në vazhdim për të trajnuar ekspertë të bashkive për sigurimin e kësaj ndërlidhje në praktikë.

Ka filluar dhënia e asistencës për përgatitjen e buxheteve të konsoliduara dhe paketave fiskale: Ministria e Financave ka organizuar një seri tryezash ku janë prezantuar ndryshimet në kuadrin ligjor për sistemin e taksave vendore, për mënyrën e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, për përgatitjen e buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm. Sesione të tjera trajnimi janë organizuar nga aktorë të tjerë prezent në nivelin lokal, ndërsa disa bashki kanë zhvilluar paketa fiskale dhe buxhetin më ndihmën edhe të projekteve të asistencës teknike. Ka nisur trainimi me personelin e buxhetit dhe financës së 61 bashkive të vendit në Menaxhimin e Financave Publike. Trainimi një vjeçar me katër sesione ka kurrikulën e dedikuar të miratuar edhe nga Ministria e Financave dhe që po zbatohet nga Shkolla e Administratës Publike (SHAP).⁹ Aktualisht qeveria po harton kuadrin e ri ligjor për financat vendore dhe me miratimin e ligjit do fillojë hartimi i buxheteve të konsoliduara. Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore ka organizuar tryeza specifike me të gjitha bashkitë e vendit për prezantimin e formulës së re të transfertës së pakushtëzuar, përgatitjes së paketave fiskale, dhe përmirësimin e administrimit tatimor në nivel vendor.

8. PLGP/USAID ka financuar harmonizimin e planeve në 5 bashki të tjera. Programi DLDP, në bazë të Programeve të Zonave Funktionale ka zhvilluar Strategjitë e Territorit për 5 Bashki: Durrës, Lezhë, Shijak, Dibër dhe Kukës, të cilat janë bërë pjesë e PPV-ve të këtyre Bashkive (që janë në zhvillim në kuadër të 26 Bashkive nga MZHU).

9. Me mbështetjen e DLDP

Objektivi strategjik: Strukturat e Qeverisjes Vendore.

Janë marrë një sërë masash të rëndësishme ligjore në drejtim të forcimit të rolit të këshillave bashkiake dhe të kryetarëve të bashkive në menaxhimin e strukturave bashkiake dhe forcimin e lidërshiptit. Amendimi i Ligjit no. 8652/2000 Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal" me Ligjin e ri Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" solli një ndryshim në funksionin e këshilltarve bashkiakë, duke e përcaktuar këtë funksion në përputhje me përcaktimet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, e cila evokon funksionin qytetar dhe komunitar të këshilltarëve. Këshilli bashkiak merr një rol më të madh në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të ecurisë dhe performancës së administratës bashkiake, në raport me vendimet e këshillit dhe pritshmërive të qytetarëve. Ky ndryshim ligjor e vendos rolin e *Këshillit Bashkiak* në një pozicion të ri, duke e pozicionuar atë *plotësisht si organi përfaqësues i interesave të komunitetit*. Njëkohësisht ndryshimet ligjore forcojnë elementet e përgjegjshmërisë publike të këshilltarëve në kryerjen e funksionit të tyre dhe parandalimin e fenomeneve korruptive të hasura shpesh në vendimmarrjet e këshilltarëve bashkiakë, duke i përcaktuar ata si subjekt i legjislacionit për konfliktin e interesave.

Ligji i ri ka forcuar gjithashtu rolin e Kryetarit të Bashkisë në drejtim të menaxhimit të Bashkisë: (i) rritjen e fuqisë së kryetarit të bashkisë për të miratuar strukturën organizative të administratës bashkiake si dhe rregulloren e brendshme të punës, (ii) krijimin e njësive administrative dhe përcaktimin e funksioneve të tyre dhe (iii) përfaqësimi juridik në raport me të tretë, veçanërisht në raport me shoqëritë tregtare me kapital të bashkisë, çështje që ka qenë problematike në vitet e kaluara.

AZRT-ja ka zhvilluar disa takime informuese me kryetarët e bashkive të reja. Me asistencën e Këshillit të Europës (KiE) është kryer vlerësimi i Nevojave për Trainim, i cili ofron të dhëna edhe mbi nevojat për trainim të kryetarëve të bashkive dhe këshilltarëve bashkiakë. Gjithashtu nga SHAP është hartuar kurrikula e trainimit për lidërshiptin e grave në nivelin vendor.¹⁰


Ka nisur procesi i zhvillimit të metodologjisë për caktimin e funksioneve / kompetencave nga niveli qendror në qeverisjen vendore. Aktualisht po përgatitet një vlerësim i cili synon të shohë sesa kanë qenë të përgatitura Bashkitë për të ofruar shërbime që burojnë nga funksionet e reja, të marra më 1 janar 2016.

Po punohet në drejtim të përcaktimit të sistemeve standarte të funksionimit administrativ të NJQV-e. Janë hartuar disa modele organigramash për bashkitë dhe manualët përkatës, si dhe skema organizative¹¹, të cilat do të përmirësohen më tej sipas specifikave të reja. Do të vazhdohet me zgjerimin e eksperiencës në bashki të tjera, duke përshtatur skemën organizative sipas tipologjive të ndryshme të bashkive.

Ende mbetet i ulët progresi lidhur me përgatitjen e modelit të përshkrimeve të punës/misionit për secilin prej njësive tipike të administratës së bashkive për secilin funksion/proces kryesor, si dhe për secilin pozicion pune tipik. Në Bashkinë e Shkodrës dhe Bashkinë Lezhë janë zhvilluar detyrat dhe përgjegjësitë e pozicioneve të punës në kuadër të ofrimit të shërbimeve administrative

10. http://www.aspa.gov.al/images/banners/Lidershipi_dhe_Gratë_në_Qeverisjen_Vendore.pdf

11. Projekti STAR I, ka hartuar disa modele organigramash dhe manual përkatës. Mbi 30 bashki kane përdorur këto modele. DLDP ka zhvilluar skema organizative në kuadër të ofrimit të shërbimeve administrative përmes IOSSH. Projekti i KiE ka ofruar dy modele strukturash, njeri prej të cilëve është i ngarkuar në sistemin E-PAV për përdorim nga NJQV.



përmes IOSSH (back-office dhe front-office), si dhe është miratuar rregullorja administrative nga Bashkia. Zgjerimi i eksperiencës në Bashki të tjera, duke përshtatur rregulloren sipas tipologjive të ndryshme të Bashkive, ka nisur në Bashkitë Vau i Dejës, Mat dhe Klos.

Me qëllim që t'u sigurohet ndihmë e vazhdueshme direkte administratave të reja bashkiake, pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) është ngritur një strukturë "help-desk" ku janë punësuar 2 ekspertë për çështjet ligjore dhe teknike dhe një ekspert nga SHAP për çështjet e trainimeve.

Ecuri jo e duhur vihet re në drejtim të përmbushjes së objektivit specifik të "Forcimit të demokracisë lokale nëpërmjet rritjes së gjithëpërfshirjes qytetare dhe forcimit të strukturave komunitare në nivel vendor". Ende nuk ka progres në drejtim të mbështetjes me infrastrukturën bashkëkohore të vendimarrjes në nivel vendor për promovimin e gjithëpërfshirjes qytetare dhe demokracisë lokale¹², ndërsa janë duke u zbatuar 2 projekte të mbështetura nga Lëviz Albania dhe OSBE për krijimin e strukturave komunitare në Tiranë, Fier, Gjirokastër dhe Vau Dejës.

Në drejtim të forcimit të dialogut midis qeverisë qendrore dhe qeverisë vendore, dhe llogaridhënies së dyanshme, po punohet në drejtim të ngritjes së Këshillit Konsultativ Qeveri Qendrore - Qeverisje Vendore dhe bashkëpunimit me shoqatat vendore. Është përgatitur projekt-vendimi përkatës dhe janë bërë konsultimet me shoqatat e bashkive. VKM pritet të miratohet brenda vitit 2016.

Hapa të rëndësishme janë ndërmarë në lidhje me zbatimin e parimit të rëndësishëm të strategjisë lidhur me forcimin e demokracisë vendore dhe qeverisjen komunitare. Ligji i ri për qeverisjen vendore vendosi bazat juridike për një kapërcim cilësor dhe të qenësishëm në qeverisjen me pjesëmarrjen e komunitetit. Për herë të parë sanksionohen me ligj krijimi i strukturave komunitare në qytete, në formën e këshillave komunitarë të lagjeve dhe mekanizmin e ndërlidhësit komunitar, duke plotësuar kështu një vakuum që kishte në hapësirën urbane në raport me fshatin ku ligji në fuqi e parashikonte strukturën e kryetarit të fshatit dhe kryesisë. Qeverisja komunitare është një qasje e re në politikën lokale në Shqipëri sidomos në pjesët urbane dhe sanksionimi me ligj i kësaj strukture do t'i japë hov nismave qytetare për gjallërimin e jetës në komunitet dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në punët e bashkisë.

Në drejtim të Programit të Transparencës dhe Pjesëmarrjes në vendimarrjen në nivel vendor po realizohet vlerësimi kombëtar i transparencës dhe llogaridhënies në qeverisjen vendore.¹³ Në gjashtë bashki: Korçë, Fier, Elbasan, Lushnjë, Berat dhe Kuçovë¹⁴ është implementuar një platformë mbështetur në ICT për transparencën mbi shpenzime dhe buxhete të njëjësive të qeverisjes vendore. Në shumë bashki janë organizuar konsultime me publikun (me këshilltarët bashkiakë, drejtoritë rajonale, shoqërinë civile dhe ekspertët e bashkive, për ligjin e pushtetit vendor. Në disa bashki po organizohen takime të rregullta ndërmjet qytetarëve dhe qeverisjes vendore, nëpërmjet Komisioneve Këshillimore Qytetare. Këto Komisione përfshijnë anëtarë nga të gjitha njësitë administrative dhe funksionojnë në kuadër të një marrëveshjeje me vetë Bashkitë, në mënyrë individuale.

12. rikonstruksioni i sallave të këshillave bashkiake të bashkive të reja, pajisja me sistemet elektronike të votimit, ambientet për pjesëmarrjen e qytetarëve/mediave në punimet e këshillave.

13. Me asistencën e KiE

14. Me asistencën e Projektit USAID –Per Planifikim dhe Qeverisje Vendore (PLGP)

Objektivi Strategjik: Strukturat e dekoncentruara


Progres i rendësishëm është arritur në drejtim të rishikimit organizativ të strukturave shtetërore në nivel vendor sipas ndarjes së re me 61 bashki si dhe referuar transferimit të funksioneve të reja.

Drejtoritë rajonale i janë nënshtruar procesit të ristrukturimit në disa sektorë: (i) *Policia e Shtetit* e ka bërë plotësisht ristrukturimin sipas ndarjes së re administrative me 61 bashki; (ii) është ristrukturuar plotësisht *administrata e Prefektëve*; (iii) *Sektori bujqësisë*: janë ristrukturuar plotësisht bordet e kullimit, duke bërë qendëzimin e tyre. Nga 13 borde rajonale tashmë janë vetëm 4 borde rajonale, ndërsa pjesa tjetër janë decentralizuar pranë bashkive; (iv) - *Shërbimi Pyjor* (pjesë e Ministrisë së Mjedisit) është ristrukturuar plotësisht dhe është decentralizuar tek bashkitë; (v) *Arsimi parauniversitar*, është ristrukturuar, duke i kaluar në varësi të bashkive, gjithë punonjësit e kopshteve (edukatorët) dhe gjithë personelin mirëmbajtës të shkollave 9 vjeçare dhe gjimnazeve; (vi) *Shërbimi Zjarrëfikës* nga niveli rajonal (në varësi të prefekturave) është decentralizuar dhe ka kaluar pranë bashkive plotësisht; (vii) *Sektori rrugor*: ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve nga qarku i kanë kaluar plotësisht bashkive.

Nga procesi i ristrukturimit i janë kaluar kompetenca dhe burime njerezore bashkive. Rreth 7100 punonjës janë transferuar nga qeveria qendrore (në qendër dhe në nivel rajonal) tek niveli i bashkive (niveli lokal).

4.2 Progresi i arritur në drejtim të Forcimit të Financave Vendore dhe Rritja e Autonomise Fiskale

Qëllimi kryesor i reformave të decentralizimit fiskal, të përcaktuara në Strategji, është mbështetja financiare e programeve të qeverisjes vendore, për të krijuar mundësi që Bashkitë të kenë më shumë burime financiare, në mënyrë që ato të kryejnë funksionet dhe kompetencat e tyre në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme. Grafiku 11 paraqet situatën e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të këtij qëllimi strategjik dhe shkallën e realizimit të tyre. Siç shihet, vetëm 4 aktivitete kanë filluar, ndërsa pjesa më e madhe e aktiviteteve do të fillojnë të zbatohen pas vitit 2016.



Numri i Aktiviteteve	
Të realizuara	7
Në zbatim	4
Nuk kanë nisur të zbatohen	9
Fillojnë pas 2016-ës	6

Grafiku 9: Shkalla e zbatimit të aktiviteteve (ne%)

Vonesat në fillimin e disa aktiviteteve të parashikuara në këtë qëllim strategjik lidhen kryesisht me procesin e hartimit të ligjit për financat vendore, i cili është parakusht për fillimin e një sërë aktiviteteve.

Objektivi strategjik: Reformimi i sistemit të të ardhurave vendore

Progresi i shënuar në kuadër të arritjes së këtij objektivi strategjik vihet re kryesisht në drejtim të **përmirësimit të qëndrueshmërisë, thjeshtësisë dhe barazisë së sistemit të transfertave si dhe rritjes së transparencës**¹⁵. Në vitin 2015, me mbështetjen e projektit PLGP/USAID, u hartua formula e re e transfertës së pakushtëzuar bazuar në kriteret më transparente, më të thjeshta dhe më objektive. Formula e re u miratua me ligjin 147/2015 "Për buxhetin e shtetit 2016". Formula, nëpërmjet elementëve të saj, mundëson barazi, objektivitet, drejtësi dhe më shumë parashikueshmëri dhe në këtë drejtim kriteret e përdorura janë: a) të dhënat e popullsisë të harmonizuara mes të dhënave të regjistrit kombëtar të gjendjes civile dhe Censurit të vitit 2011; b) dëndësia e popullsisë për km²; c) Numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki; d) Ekualizimi fiskal i mbështetur në taksat e ndara me qëllim mos penalizimin e njërive që mbledhin të ardhura dhe kompensimin e atyre që për arsye objektive nuk sigurojnë të ardhura. Ministria e Financave ka organizuar disa dëgjesa publike në nivelin lokal lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2016¹⁶ dhe 2017¹⁷.

Tashmë, transferat për qeverisjen vendore përdorin një bazë të unifikuar të të dhënave të popullsisë. Po vijon procesi i rishikimit të sistemit të granteve të kushtëzuara (FZHR, etj.) për ta fokusuar atë në zonat me rëndësi më të madhe rajonale, si dhe për ta sjellë atë sa më pranë praktikave të nevojshme për thithjen e fondeve të BE-së në të ardhmen.

Me buxhetin e vitit 2016, janë transferuar në nivel vendor funksionet si:

- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH)
- Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.
- Ndërtimi, dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale rajonale,
- Administrimi i pyjeve dhe kullotave
- Ujitja dhe kullimi
- Menaxhimi i disa qendrave sociale të cilat ofrojnë shërbime në nivel vendor (5 qendra në total)

Objektivi Strategjik: Përmirësimi i menaxhimit financiar në nivelin vendor


Treguesit makroekonomike kanë pësuar përmirësime të ndjeshme lidhur me planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për pushtetin vendor. Sic shihet nga grafiku më poshtë pesha specifike e të ardhurave të planifikuara për pushtetin vendor kundrejt PBB në vitin 2016 ka arritur në 1.1%, u rritur më 0.3 pike përqind në buxhetin e vitit 2016 kundrejt vitit 2013 dhe më 0.2 pike përqindje ndaj vitit 2015. Ndërsa niveli i shpenzimeve për qeverisjen vendore kundrejt PBB në vitin 2016 është planifikuar në masën 3.2% duke bërë që shpenzimet buxhetore të pësojnë një rritje në vitin 2016 prej 0.4 pike përqind kundrejt vitit 2015 dhe 1% më shumë kundrejt nivelit të shpenzimeve për PV të realizuara në vitin 2013.

15. Objektivi Specifik II.2:

16. Shih: Raporti I Monitorimit 2015: Strategjia e Financave Publike 2014 -2020, fq 19

17. 4 Tetor 2016, u zhvillua takimi i parë konsultues me Kryetarët e Bashkive të vendit për të diskutuar mbi hartimin e Buxhetit për vitin 2017 <http://www.km.dldp.al/blog/diskutohet-buxheti-2017/>

Grafiku 10: Peshë specifike e të ardhurave dhe shpenzimeve të Pushteti Vendor në % kundrejt PBB



Burimi: PBA 2016-2018

Kurse nëse i krahasojmë parashikimin e të ardhurave e shpenzimeve sipas parashikimit makroekonomik në Programin Buxhetor Afatmesëm 2016-2018, vihet re se të ardhurat e planifikuara në vitin 2016 janë rreth 52% më të mëdha se sa viti 2013, dhe 31% më të mëdha se sa viti 2015, ndërsa shpenzimet janë parashikuar në vlerë nominale 66%, më shumë se në vitin 2013 dhe 23% më shumë se në vitin 2015.

Tabela 2: Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore për PV

	% Te Ardhurat PV Milion leke	Shpenzimet per PV Milion leke	Rritja ndaj 2013 ne %		Rritja ndaj vitit paraardhës %	
			Ardh	Shpenz	Ardh	Shpenz
Fakt 2013	10,825	29,787				
Fakt 2014	12,773	37,199	18%	25%	18%	25%
Akt Normativ 2015	12,563	40,377	16%	36%	-2%	9%
Buxheti 2016	16,502	49,565	52%	66%	31%	23%

Hartimi i kuadrit ligjor dhe mbështetja e vazhdueshme e bashkive janë hapa të rëndësishëm, në drejtim të rritjes së kapacitetit të të ardhurave vendore të NJQV për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve.¹⁸


Bazuar në një proces konsultativ midis qeverisë qendrore dhe përfaqësuesve të qeverisë vendore, Ministria e Financave në bashkëpunim me MSHCV janë duke punuar për projektligjin "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore".¹⁹ Ligji synon të harmonizojë rregullime në lidhje me menaxhimin e financave publike, rrisë transparencën, përgjegjshmërinë dhe qëndrueshmërinë financiare vendore. Ligji pritet të miratohet nga Kuvendi brenda vitit 2016. Ka filluar procesi i analizimit të ndikimeve të ndarjes së taksave kombëtare me NJQV-të²⁰ dhe pritet të finalizohet gjatë procesit të hartimit të ligjit për financat vendore. Në 12 bashki²¹ është dhënë mbështetje për administratën tatimore vendore për administrimin e taksës së pasurisë dhe taksat vendore. Janë hartuar Planet e Veprimit për përmirësimin e regjistrimit të bazës së taksueshme dhe është ofruar asistencë për zbatimin e tyre në pesë bashki. Në këtë kuadër janë zhvilluar katër aktivitete rajonale për ndarjen e ekpëriencave më të mira dhe ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve vendore.

18. Objektivi Specifik II.1

19. Hartuar me ndihmën e projekteve PLGP/USAID dhe DLDP nën drejtimin e Ministrisë së Financave.

20. Kryer pjesërisht nëpërmjet rekomandimeve të dokumentave politike dhe vlerësimit të bërë nga PLGP/USAID.

21. Me asistencën e projektit PLGP/USAID



Ende nuk ka progres në drejtim të rritjes së kapaciteteve të NJQV, që të përdorin huamarrjen dhe borxhin për financimin e investimeve kapitale brenda politikave kombëtare të borxhit publik.²² Ligji për huamarrjen vendorei rishikuar pritet të miratohet së shpejti. Gjatë kësaj periudhe është mundësuar identifikimi i borxheve të fshehura të krijuara para ndryshimit të hartës së NJQV-ve. Është hartuar Raporti i Borxheve dhe Detyrimeve të Prapambetura me asistencën e projektit STAR 1. Sipas vlerësimit niveli i borxhit deri në fund të vitit 2015 vlerësohet të jetë 9,7 miliard lekë.

Hapa të rëndësishme ligjore janë ndërmarrë në drejtim të konsolidimit të sistemit të buxhetimit dhe menaxhimit financiar në nivelin vendor. Ndryshimet e fundit të Ligjit Organik të Buxhetit, realizuar me Ligjin nr. 57/2016 përfshijnë në mënyrë të zgjeruar e detajuar rregullat e reja të menaxhimit të sistemit të buxhetit në nivelin vendor. Ligji i ri përcakton qartë rregullat dhe procedurat e hartimit të miratimit të buxhetit vendor dhe programin buxhetor afatmesëm. Një nga risitë e rëndësishme të ligjit është detyrimi ligjor i vendosur që përcakton organizimin nga Ministria e Financave e takimeve me njësitë e qeverisjes vendore për programin buxhetor afatmesëm.

Ka pasur ecuri të mirë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve për forcimin e sistemit të administrimit të financave publike në nivel vendor. Është punuar në drejtim të përmirësimit të kapacitetit të përgjithshëm të NJQV-ve në fushën e hartimit dhe zbatimit të buxhetit dhe përhapjes së procesit të buxhetimit afatmesëm (PBA) në të gjitha NJQV-të, duke mundësuar përdorimin e përjasjes PZHS dhe PBA (SDPeMTBP) për të gjitha NJQV-të. SHAP po zbaton programin 1-vjeçar të trainimit të vazhdueshëm për Planifikimin Strategjik dhe Menaxhimin e Financave Publike në nivel vendor.²³ Gjatë kësaj periudhe është zhvilluar Kursi i plotë (5 module), ku janë trainuar 40 punonjës të 40 bashkive të reja, si dhe do të kryhet testimi me shkrim dhe çertifikimi i punonjësve. Gjithashtu janë identifikuar praktike të mira për hartimin e buxhetit vjetor.

Një theks i veçantë i është vënë lidhjes së strategjive territoriale me Programet buxhetore afatmesme, në fazën e hartimit të tyre, për t'i bërë këto strategji sa më të qëndrueshme financiarisht. Programi DLDP po asiston 10 Bashki (Shkodër, Durrës, Lezhë, Malësi e Madhe, Kukës, Tropojë, Dibër, Klos, Mat dhe Shijak) në hartimin e Paketës Fiskale 2017, hartimin e buxhetit vjetor 2017 dhe hartimin e PBA 2018-2020, të lidhura këto me Strategjitë territoriale që po hartohen në kuadër të hartimit të PPV.

Ende nuk ka progres në zbatimin e Sistemit të kompjuterizuar të Informacionit Financiar të Thesarit në nivel vendor. Nga 61 bashki, sistemi i IFTH funksionon vetëm në Bashkinë e Tiranës. Pavarësisht sistemit të IFTH, në vitin 2016 pritet që për herë të parë bilanci financiar të NJQV të jenë pjesë e Pasqyrave Financiare të Qeverisë, duke siguruar në këtë mënyrë pasqyrim të saktë të financave vendore në sistemin qeveritar.²⁴

Vëmendje më e madhe duhet ti kushtohet zgjerimit të reformës së Auditimit²⁵ për të fuqizuar qeverisjen vendore si dhe monitorimin e performancës së progresit të reformave në fushën e Menaxhimit të Financave Publike. Siç konstatohet në raportin e Ministrisë së Financave për vitin 2015, kapacitetet e auditimit të brendshëm - plotësimi i strukturave audituese mbetet ende problem në nivelin vendor. Në vitin 2015 pushteti lokal vlerësohet me një efektivitet prej 73%, më i ulët se dy vitet e mëparëshme, e cila vjen si pasojë e mungesës së njësive të

22. Objektivi Specifik II.3

23. Me mbështetjen e Programit DLDP

24. Shih: Raporti i Monitorimit 2015: Strategjia e Financave Publike 2014 -2020, fq 25

25. Auditimit të Brendshëm dhe Kontrollit, Auditimit të Jashtëm dhe Prokurimit Publik

auditimit të brendshëm në një numër të konsiderueshëm institucionesh vendore.²⁶ Në total, deri në fund të vitit 2015 strukturat e auditimit të brendshëm ekzistojnë në 25 bashki.

Ministria e Financave ka trajnuar stafet e njësive të auditimit të brendshëm, në disa njësi ekzistuese gjatë vitit 2015 dhe 2016. Në maj të vitit 2016 u trajnuan të 41 shefat e financave të bashkive.


Me qëllim vlerësimin e sistemit të menaxhimit buxhetor e financiar ka filluar zbatimi i PEFA (Public Expenditure and Financial Accountability) në 5 Bashki të vendit nga SECO dhe PLGP/USAID në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

4.3 Progresi i arritur në drejtim të Nxitjes së Zhvillimit të Qëndrueshëm Vendor


Strategjia përcakton rishikimin e funksioneve të qeverisjes vendore pas reformës administrative-territoriale si një nga prioritetet kryesore, me qëllim ripërcaktimin e përgjegjësisë së autoriteteve vendore mbi funksionet e veta dhe të përbashkëta, të cilat tashmë janë miratuar nga ligji i ri organik i qeverisjes vendore.

Sic paraqitet në grafikët e mëposhtëm, rreth 1/3 e aktiviteteve të parashikuara nën këtë qëllim prioritar, janë realizuar gjatë vitit të parë të zbatimit të strategjisë. Progres më i madh shihet nën objektivin funksione të vetat, i cili ka edhe numrin më të madh të aktiviteteve të realizuara, 11 kundrejt 8 aktiviteteve në total.

Grafiku 13: Shkalla e Realizimit të aktiviteteve në total për Qëllimin Strategjik – III (në %)



Grafiku 14: Shkalla e Realizimit të Aktiviteteve sipas Objektivave Strategjike (në numër)



Ligji i ri për funksionimin e qeverisë vendore parashikon një tipologji të re të funksioneve të qeverisjes vendore duke i klasifikuar ato në funksione dhe funksione të deleguara. Hiqet ndarja në "funksione të veta" dhe "funksione të përbashkëta". Ky ndryshim vjen në përputhje me Kushtetutën, e cila nuk e njeht konceptin e "funksionit të vet apo të përbashkët" midis qeverisë dhe qeverisjes vendore. Futja e kësaj tipologjie të funksioneve dhe përcaktimi që funksionet dhe kompetencat kalojnë vetëm me ligj krijon një bazë solide dhe një praktikë e mirë për respektimin e autonomisë vendore.

Për efekte të raportimit të zbatimit të strategjisë, dhe pasqyrimin të arritjeve në kuadër të objektivave të caktuara, raportimi i mëposhtëm do të marrë parasysh këtë tipologji të re të funksioneve.

26. Ministria e Financave: Raport mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme për Vitin 2015, fq. 10,16

Objektivi Strategjik: Funkzionet e qeverisë vendore

Progres më i ndjeshëm vihet re në drejtim të zbatimit të Objektivit Strategjik të Funksioneve të qeverisjes vendore. Miratimi i kuadrit ligjor i hapë rrugë zbatimit eficient të funksioneve të veta, bazuar në një kuadër ligjor të qartë dhe të harmonizuar. Hartimi i ligjit të ri për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, u realizua nëpërmjet një procesi konsultativ, i cili u finalizua me miratimin e tij në 17 dhjetor 2015²⁷. Nëpërmjet ligjit u realizua dhe rishikimi i funksioneve dhe kompetencave të NjQV, si bashkive edhe qarqeve. Roli i qarkut u përcaktua si njësi që do të vazhdojë të sigurojë harmonizimin e politikave lokale me politikat kombëtare të zhvillimit rajonal. Gjithashtu u miratua VKM për funksionet e reja.

Përmirësimi i cilësisë dhe infrastrukturës në bazë të standardeve minimale kombëtare të detyruara që duhen përcaktuar, mbetet ende një sfidë e rëndësishme për tu adresuar. Rishikimi i legjislacionit për shërbimet publike/ndërmarrjet publike në nivel vendor u realizua pjesërisht me ligjin 139/2015 për qeverisjen vendore dhe po vazhdon puna për plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor.

A. Infrastruktura vendore dhe shërbimet publike

Në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, nëpërmjet Ligjit 139/2015 si dhe VKM Nr.63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e Ndërmarrjeve të Ujësjellës - Kanalizimeve" u mundësua rishikimi i skemës së funksioneve dhe kompetencave në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore, është duke mbështetur disa nga Bashkitë me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi për hartimin e Planeve të Tranzicionit. Bashkitë, kanë ngritur grupet e punës për marrjen në dorëzim të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese të Ujësjellësave, por, procesi i transferimit të ujësjellësave akoma nuk ka përfunduar.


Në fushën e mbetjeve urbane, Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me GIZ, planifikon rishikimin e strategjisë në këtë sektor. Në zbatim të rekomandimeve të Konferencës Kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, të mbajtur në 20 Maj 2016²⁸, do të punohet për të siguruar pronësinë e bashkive për menaxhimin e mbetjeve, duke rregulluar rolet e Qeverisë Qëndrore për zbatim dhe investim lidhur veçanërisht me zonat problematike të depozitimit ilegal të mbetjeve, venddepozimet, landfillet dhe inceneratorët (pjesa e përgjithshme e trajtimit të mbetjeve). MZHU është në proces të popullimit të mëtejshëm me të dhëna të hartës dixhitale të menaxhimit të mbetjeve, si dhe në bashkëpunim me KfW ka nisur hartimin e Masterplanit të Mbetjeve.

SECO dhe BE janë në fazën përgatitore për mobilizimin e fondeve për mbështetjen e qeverisjes vendore në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Sa i përket mbështetjes së bashkive për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, gjatë vitit 2015, pesë bashki, Shkodër, Lezhë, Kukës, Malësi e Madhe dhe Pukë, me mbështetjen e programit DLDP kanë kryer auditimin e shërbimit dhe në hartimin e planeve afatshkurtra të veprimit për t'iu përgjigjur ndryshimeve që solli reforma territoriale. Gjatë vitit 2016 ka filluar hartimi i planeve vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve në 6 bashki Shijak, Dibër, Lezhë, Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Këto plane menaxhimi (përveç atij të

27. Ligji 138/2015 "Per vetëqeverisjen vendore".

28. <http://www.mjedisi.gov.al/al/newsroom/lajme/zhvillohet-konferenca-sektori-i-menaxhimit-te-mbetjeve-sfidat-dhe-mundesite&page=16>



bashkisë Shkodër që do të përfundojë në 2017), të cilat priten të përfundojnë brenda vitit 2016, do të bazohen në metodologjinë e planifikimit mbi bazë performance²⁹. Ky planifikim realist dhe i bazuar në performance do të ndihmojë në përcaktimin e një standarti minimal të përbalueshëm shërbimi (Ligji 139/2015 dhe Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”).

Janë zgjeruar me tej funksionet e NjQV-e në fushën e ujitjes dhe kullimit. Rishikimi i legjislacionit për decentralizimin e funksionit të mirëmbajtjes së rrjetit dytësor dhe tretësor të ujitjes dhe kullimit, u krye pjesërisht me ligjin 139/2015 dhe VKM për transferimin e kanaleve ujitëse-kulluese dhe riorganizimin e bordeve të kullimit (VKM 1107/2015 dhe VKM 1108/2015³⁰). Aktualisht është përgatitur projektligji "Për ujitjen dhe kullimin" që pritet të miratohet në 2016. Miratimi i ligjit do të përmbyllë procesin e plotë të decentralizimit të këtij funksioni. Reforma e nisur në shërbimin e ujitjes dhe kullimit konsiston: Së pari, në ri-konceptimin e rolit, përgjegjësive dhe funksioneve të Bordeve të Kullimit; së dyti, në decentralizimin e kompetencave dhe kalimin tek bashkitë të përgjegjësive të menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre. Bashkitë kanë autoritetin dhe kapacitetin për të menaxhuar dhe investuar më mirë në sistemet e ujitjes dhe kullimit. Me ligjin e ri ato do marrin rol parësor në menaxhimin e sektorit të ujitjes dhe kullimit, nëpërmjet³¹: (i) transferimit të të drejtës së pronësisë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe kalimin e përgjegjësive për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së transferuar; (ii) përcaktimit të tarifave të shërbimit të ujitjes/kullimit dhe mbledhjen e tyre duke synuar një mbulim gradual të kostove; (iii) mobilizimit të burimeve të tjera financiare nga vetë ato apo sigurimit të granteve nga buxheti i shtetit, mbi bazën e nevojave dhe performancës së arritur³². Organizimi i shërbimit të ujitjes nga vetë bashkia do të bëhet në përshtatje me madhësinë e skemës ujitëse, gjëndjen e saj, traditën, shkallën e kooperimit të fermerëve etj.

Paralelisht me hartimin e kuadrit ligjor ka vijuar puna për hartimin e planeve lokale për menaxhimin dhe investimet në rrjetin dytësor dhe tretësor të ujitjes dhe kullimit. Me asistencën e donatoreve si dhe projektit STAR në vitin 2017-2018 parashikohet hartimi i 61 planeve lokale për zhvillimin e infrastrukturës së ujitjes e kullimit.

Bashkitë po mbështeten nga buxheti i shtetit me investime për rehabilitimin e skemave ujitëse, mjete për pastrimin e kanaleve ujitës dhe kullues, personel etj.³³ 267 punonjës janë transferuar nga Ministria në administratat e Bashkive; 39 Makineri të medha dhe të vogla janë transferuara në 31 bashki si dhe janë blerë 61 ekavatorë të rinj, të cilët janë transferuar pranë bashkive.

29. Metodologji e hartuar me mbështetjen e Programit DLDP

30. Ligji 139 (2015), neni 27 "Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve publike, natyrës dhe biodiversitetit", përcakton rolin e Bashkive në ushtrimin e këtyre kompetencave dhe përkrahin administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

31. Shih "Relacion për projekt – ligjin "Për administrimin e sistemit të ujitjes e kullimit" http://www.bujqesia.gov.al/files/pages_files/Relacioni_i_p.ligjit.pdf

32. VKM 1107, datë 30.12.2015 "Për krijimin e bordeve rajonale të kullimit Lezhe, Durres, Fier dhe Korce"

33. VKM nr.90, datë 4.02.2016 "Për detajimin e fondit të investimeve për funksionin e ujitjes dhe kullimit" (fond nga buxheti i shtetit prej 2.45 Miliard leke), VKM 129, datë 17.02.2016 "Për shtesë fondesh në buxhetin e bashkive për vitin 2016 për pastrimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese" (fond prej 111 Milion leke); Fond nga buxheti në vlerën 2.561 Miliard leke për pastrimin e kanaleve dhe blerjen e 61 eskavatoreve të rinj.

Kutia 1: Rezultatet e para te arritura në vitin 2016

- Janë pastruar ne total 1000 km linear kanale ujitës dhe kullues;
- Janë hequr mbi 1 mln m³ (metër kub) dhera; Në 2017 synohet 4 milionë m³.
- Janë ndërtuar 41 vepra te reja infrastrukture (kanale te rinj apo veshje me beton);
- Janë rehabilituar 500 vepra infrastrukture;
- Kanë përfituar 220,000 familje fermerësh;
- Që nga 1991 për herë të parë është bërë funksional sistemi i ujitjes dhe kullimit për 22,000 ha toke bujqësore (sisteme të reja);
- Janë përmirësuar parametrat e ujitjes dhe kullimit për 40,000 ha toke.


Nëpërmjet decentralizimit për shkak te shtrirjes, aksesit dhe ndërhyrjes se decentralizuar pothuajse ne te gjitha 61 bashkitë **është rritur me 15-20 herë më shume Operacionaliteti**, sesa kur ky funksion kryhej nga 13 bordet e kullimit.

Burimi: Fjala e Ministrit të Shtetit Z.Blendi Cuci në Konferencën “ Decentralizimi, një vit më pas,” 28 Shtator 2016

Është kryer riorganizimi i bordeve të kullimit në katër rajonet kryesore që lidhet kryesisht me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kryesore kulluese (të 20 skemave të mëdha ujtese), hidrovoret dhe 7 rezervuarë të mëdhenj si dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytjet (diga, argjinatura lumore dhe detare si dhe kanalet e ujrave të larta).

Në vijim do të realizohet Trajnimi i Trajnerëve (TOT) me mbështetjen e Projektit të Bankës Botërore në 10 Bashki gjatë fazes së parë në aspekte si njohja e legjislacionit dhe menaxhimi teknik për mirë-administrimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit. ToT do të japin trajnime për punonjësit e strukturave të reja organizative të krijuar në nivel bashkie me decentralizimin e funksionit të sistemit të ujitjes dhe kullimit.

Grafiku 13: Burimet Njerezore te tranferuar nga QQ ne Bashkite
Funksioni i Ujitjes dhe Kullimit



Burimi: MBZHRAU

Është në zbatim programi per standartet minimale në shërbimet publike në nivel vendor. Në muajin korrik 2016 u miratuan standartet e projektimit të çerdheve³⁴ hartuar nga Ministria e Zhvillimit Urban. Standartet do të shërbejnë si referencë për të gjithë ata, që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të çerdheve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese³⁵.

34. <http://www.zhvillimiurban.gov.al/newsroom/lajme/miratohen-standardet-për-projektimin-e-çerdheve>

35. http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/userfiles/lajme/Standardet_e_Projektimit_të_Cerdheve_18_07_2016.pdf


Vendimi i Qeverisë për standardet synon t'i japë zgjidhje problematikave të krijuara nga mungesa e standardeve të miratuara për projektimin e çerdheve, si dhe do të ndikojë në rritjen e cilësisë dhe sigurisë në shërbimin e ofruar për përdoruesit e çerdheve. Këto standarde janë shumë të rëndësishme për NjQV për të siguruar shpërdarjen e investimeve në lidhje me investimet në çerdhe dhe kopshtet publike.

Në vitin 2016 ka rifilluar procesi i transferimit të pronave në bashkitë e reja, dhe regjistrimi i tyre duke mundësuar përdorimin e tyre më shumë në funksion të ekonomive lokale. Është aprovuar transferimi 100% i pyjeve dhe kullotave tek 61 bashkitë e reja, duke shfuqizuar mbi 300VKM të mëparshme për transferimin tek ish-komunat. Aprovimi i këtij vendimi i hap rrugë *menaxhimit të aseteve nga ana e bashkive të reja dhe mundësimin e përdorimit të tyre më shumë në funksion të ekonomive lokale.*

Duhet përmendur se procesi i zbatimit të reformës administrative- territorial rezultoi në bllokimin e përkohshëm të transferimit të pronave, pasi solli ndryshimin e njësive të qeverisjes vendore, nëpërmjet eliminimit të njësive të mëparshme dhe krijimit të Bashkive të reja. Prosesi i inventarizimit dhe transferimit (ne vijim) kalon në tre faza.³⁶ Pas miratimit të fazës së tretë, fillojnë procedurat e regjistrimit të pronave në ZRPP-në e rrethit. Për këtë qëllim është e nevojshme, që për të gjitha pronat, NJQV të përgatisin planimetritë dhe planvendosjet e tyre, të cilat do të regjistrohen sipas VKM. Agjensia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike komunikon rregullisht me Bashkitë për të siguruar ecurinë e procesit të regjistrimit të pronave. Deri tani janë miratuar dy lista përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim, për Bashkinë Patos (Qarku Fier).

Grafiku i mëposhtëm jep një pasqyrë të përgjithshme të situatës lidhur me procesin e regjistrimit të pronave në rang kombëtar. Sic shihet në 99% të njësive administrative (373 Njësi Administrative- NjA) janë miratuar listat e inventarit të pronave, në 71% ose 265 NjA janë miratuar listat paraprake dhe në 45% ose 168 NjA, janë miratuar listat përfundimtare.


Grafiku 14: Statusi i Procesit të Regjistrimit të Pronave në Nivel Kombëtar (në % NjA)



Grafiku i mëposhtëm jep një pasqyrë të detajuar të gjëndjes së procesit të regjistrimit të pronave sipas qarqeve.

36. Faza 1: Këshilli i Ministrave miraton listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore. Faza 2: Miratimi i listës paraprake të pronave, që propozohet nga këshilli i njësive të qeverisjes vendore për tu transferuar në pronësi ose në përdorim. Faza 3 : Miratimi nga Këshilli i Ministrave i listës përfundimtare të pronave që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësive të qeverisjes vendore.

Grafiku 15: Statusi i Procesit të Rregjistrimit të Pronave sipas Qarqeve
(sipas numrit të NjA)



Sic paraqitet në grafik, më mirë paraqitet Qarku i Tiranës ku miratimi i listave të inventarit dhe paraprake ka përfunduar 100% në të gjitha NjA dhe miratimi i listave përfundimtare në 69% të tyre.

Me synim krijimin e një sistemi të dixhitalizuar integral në nivel kombëtar dhe vendor për regjistrat e pronave të transferuara tek qeveria vendore, me mbështetjen e OSBE-së është kryer paraprakisht një vlerësim për sistemin e rregjistrimit të pronave bashkiake. Raporti i vlerësimit pritet të dalë në fund të vitit 2016.

Përfundoi me sukses inventarizimi dhe riklasifikimi i rrjetit të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale, por ende nuk ka progres lidhur me ngritjen e një sistemi të integruar të planifikimit të mirëmbajtjes së rrugëve. Ky proces u finalizua me miratimin me VKM 915, dt. 11.11.2015³⁷ "Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve të bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve". Transferimi i infrastrukturës rrugore duhet shoqëruar edhe me transferimin e plotë të fondeve për mirëmbajtjen e tyre pranë bashkive. Edhe pse i gjithë inventari i rrugëve ka kaluar pranë NjQV, ende nuk ka progres në aplikimin e një sistemi të integruar të planifikimit të mirëmbajtjes së rrugëve në nivel vendor.

Strategjia e vë fokusin **tek sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik vendor me anë të projektimit dhe zbatimit të kuadrit të përshtatshëm të politikave dhe mekanizmave të bashkërendimit të tyre**³⁸. Një sërë ndryshimesh ligjore sektoriale fuqizojnë rolin e NjQV-ve për investimet strategjike, partneritetin publik-privat, menaxhimin e aseteve vendore. Paralelisht po punohet për përcaktimin e akteve nënligjore përkatëse.

39. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/199-2015.pdf

38. Objektiv i Specifik III.1.3

B. Funkcionet e veta në fushën sociale, kulturore dhe sportive

Shërbimet sociale dhe të përkujdesit social

Për të siguruar një qasje të integruar mbi ofrimin e shërbimeve të harmonizuara sociale dhe përfshirjes sociale, është miratuar nga Qeveria në Gusht 2016, draft ligji "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror". Ky ligj i ri do të përcaktojë edhe ndryshimet përkatëse të strukturave të NJQV (projekt ligji pritet të miratohet së shpejti),

Projektligji përcakton ngritjen pranë çdo bashkie të strukturës së dedikuar për shërbimet shoqërore, si njësi më vete brenda strukturës së Bashkisë. Kjo zgjidh situatën e zvarritjes së përfituesve në zyrat e administratës, qendrore apo lokale, sepse tashmë kanë një adresë të qartë pranë Bashkisë se ku mund të drejtohen. Gjithashtu draft-ligji përcakton dhe ngritjen e fondit social pranë çdo bashkie në të njëjtën linjë dhe sipas parashikimeve edhe të Ligjit për qeverisjen vendore. Draft ligji përcakton edhe mënyrën e financimit të këtyre shërbimeve dhe rolin e Bashkive në aspektet e menaxhimit të procesit të financimit. Shërbimet shoqërore do të përfitojnë financimin, vetëm nëse ato kanë një marrëveshje trepalëshe me Shërbimin Social Shtetëror dhe njësinë e qeverisjes vendore ku ofrojnë shërbimin.

Aktualisht 5 qendra të kujdesit social janë transferuar në Bashkitë Shkodër, Elbasan, Berat, Polican dhe Korçë. Ndërsa në transfertën specifike të vitit 2016 të Bashkive: Berat, Elbasan, Shkodër, Kuçovë dhe Kukës u janë kaluar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, "Lira", Berat, "Balash", Elbasan, "Shpresa" Shkodër dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për Bashkinë Kuçovë dhe Kukës.

Ndryshimet ligjore ndikuan në rritjen e fondit që Bashkitë mund të përdorin për përcaktimin e familjeve që do të përfitojnë ndihmën ekonomike. Amendimi i bazës ligjore për sektorin social në vitin 2016, përfshirë disa akte të reja nënligjore të miratuara³⁹ lidhur me dhënien e ndihmës ekonomike në nivel qendror dhe vendor, kanë mundësuar edhe disa përparësi ligjore për NJQV. Përparësia e këtyre ndryshimeve ligjore është rritja e kufirit nga 3% në 6% të fondit të kushtëzuar, duke u lënë më shumë mundësi bashkive, nëpërmjet rritjes së fondit që ata përdorin për përcaktimin e familjeve që do të përfitojnë ndihmën ekonomike, bazuar mbi kriteret e drejta të përzgjedhjes⁴⁰.

NjQV do të mbështeten për të ngritur e forcuar strukturat e posaçme për **barazinë gjinore**⁴¹, duke siguruar një monitorim dhe vlerësim periodik në bazë të treguesve të harmonizuar gjinorë dhe standardeve të shërbimeve.


Progres është arritur në drejtim të hartimit të kuadrit strategjik dhe ligjor për strehimin social. Qeveria miratoi në muajin qershor 2016, Strategjinë e Strehimit Social 2016-2025⁴². Hartimi i kësaj strategjie u realizua në harmoni edhe me SNDQV. Një prioritet i rëndësishëm i kësaj strategjie është "Forcimi i kapaciteteve vendore në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave

39. VKM nr. 197 date 9.03.2016 "Per disa shtesa dhe ndryshime të VKM nr.904, date 12.12.2012" Per përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të perfutimit të NE në zonat pilot"; Udhëzimi Nr. 14, date 10.05.2016 "Per ofrimin e shërbimit të emergjencës në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror të financuar nga fondet e buxhetit të shtetit që ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidencial për fëmijet në nevojë".

40. Ligj Nr. 44/2016 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 9355, Datë 10.3.2005, "Për Ndhimën Dhe Shërbimet Shoqërore", të Ndryshuar "Neni 21 Këshilli bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administratori shoqëror. . <https://www.parlament.al/ep-content/uploads/2016/04/ligj-nr-44-dt-21-4-2016.pdf>

41. Bazuar në Ligjin 9970/2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" i cili përcakton detyrimin që NjQV të bashkëpunojnë në zbatimin e legjisllacionit dhe politikave shtetërore për barazinë gjinore.

42. http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/userfiles/Plane_pune_dhe_Strategjite/Strategjia_e_Strehimit_Social_2016_-_2025.pdf



rreth strehimit social duke rritur rolin e NjQV-e⁴³ ". Forcimi i kapaciteteve vendore do të fokusohet në ngritjen e sistemit të të dhënave dhe trajnimin e specialistëve të strehimit, duke krijuar në të 61 njësitë vendore një sistem të grumbullimit të informacionit rreth aplikantëve dhe përfituesve të strehimit social, si dhe të burimeve lokale, të cilat mund të mobilizohen me qëllim ofrimin e programeve të strehimit social si dhe trainimit të specialistëve të strehimit që do të trajnohen rreth ofrimit të shërbimit të strehimit. Pas miratimit të strategjisë pritet të realizohet brënda vitit 2016 miratimi i Ligjit për strehimin social. Më tej do vazhdojë puna dhe mbështetja për hartimin e planeve të strehimit social në nivel vendor.

Në fushën e Kulturës ende nuk ka progres lidhur me rishikimin e kuadrit ligjor për qartësimin i funksioneve e përgjegjësi në fushën e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore, si dhe ngritjen e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor; Në kuadër të decentralizimit të disa funksioneve në NJQV, është kryer transferimi i disa qendrave për fëmijë, kompetencë e Ministrisë së Kulturës në disa Bashki.

C. Zhvillimi ekonomik vendor

Për forcimin e rolit të NJQV dhe rritjen e efektivitetit në kryerjen e shërbimeve publike, si dhe në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", qeveria miratoi disa vendime (VKM) mbi transferimin e disa funksioneve nga Ministrinë e Linjës (ML) në Bashkitë.

Funksionet e transferuara nga Qeveria Qëndrore bashkive janë:

1. Rrugët rurale
2. Funksioni i arsimit parashkollor dhe parauniversitar
3. Funksioni i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi
4. Funksioni për ujitjen dhe kullimin
5. Funksioni i pyjeve dhe kullotave

Data efektive për transferimin e kompetencave të reja ishte 1 Janar 2016. Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit (nr.127, dt. 16.09.2015), Ministrinë e Linjës përgatitën bazën ligjore (projekt-aktet) për transferimin e aseteve (të luajtshme dhe të paluajtshme), transferimin e burimeve njerëzore dhe fondin për paga. Gjatë periudhës Janar-Mars 2016, me qëllim lehtësimin e procesit të transferimit të funksioneve të reja, u organizuan nga Ministri i Shtetit për Cështjet Vendore dhe AZRT si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës, 4 sesione informimi në Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Korçë. Në fokus të këtyre takimeve ishte asistencë direkte që ju dha bashkive për të organizuar sa më mire punën në lidhje me funksionet e reja të transferuar.

Pavarësisht arritjeve në drejtim të miratimit të legjislacionit, ende ka sfida në drejtim të zbatimit të këtyre funksioneve. Transferimi i funksionit për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, kërkon një sasi fondesh të mjaftueshme për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor rural.

43. Ky prioritet synon njohjen e qartë të kërkesës dhe ofertës për strehim përmes ngritjes së një sistemi që siguron njohuri të kërkesës dhe ofertës për strehim në mënyrë periodike në të gjitha njësitë vendore. Çdo njësi vendore do të ketë një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm të të dhënave. Njëkohësisht, të gjitha njësitë vendore do të identifikojnë burimet apo asetet që ato zotërojnë apo mund të sigurojnë në bashkëpunim me aktorë të nivelit qendror dhe vendor me qëllim ofrimin e strehimit social. shih Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 fq.19).



Turizmi

Me asistencën e programeve të OKB-së po nxitet konsolidimi i partneriteteve ekzistuese territoriale ndërmjet NJQV-ve shqiptare dhe ato nga vendet e BE. Në këtë kuadër, PNUD ka lehtësuar bashkëpunimin në mes të njësive administrative të zgjedhura në rajonin e Shkodrës, përfshirë këshillin e qarkut, me Rajonin Autonom Italian të Friuli-Venezia Giulia, në zbatimin e dy nismave të projektit: i) rehabilitimin fizik dhe përshtatjen për qëllime turistike të arkitekturës tradicionale të gjashtë guesthouses në Alpet shqiptare dhe ngritjen e kapaciteteve të 25 banorëve lokalë për të kthyer ata në udhëzues dhe ofrues të shërbimeve turistike; ii) institucionalizimin e procesit të dixhitalizimit, katalogimin dhe të hapjes për World Wide Web të njëqind mijë imazheve të shekullit të 19 nga arkivi fotografisë Marubi, më i vjetër dhe më i madhi në Ballkan. Këto iniciativa synojnë heqjen/zbutjen e varfërisë dhe rritjen e vizionit e kapaciteteve të administratave lokale, për të shfrytëzuar potencialin e tyre të brendshëm, dhe promovimin e kulturës dhe historisë, si dhe gjenerimin e të ardhurave nëpërmjet rritjes së turizmit⁴⁴.

Planet Strategjike të Zhvillimit

Për të luftuar informalitetin në zhvillimin e territorit, hapësirave urbane e rurale dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, Qeveria ndërmorri nismën për hartimin e **Planeve Kombëtare dhe Vendore**, të cilat janë dokumenta në ndihmë Bashkive dhe institucioneve të qeverisë qendrore për të gjitha aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm të zonave përkatëse.

Në vitin 2016 u miratuan **Tre plane kombëtare** :

- o Plani i Përgjithshëm Kombëtar.
- o Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin.
- o Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës.

Në proces është hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV) që po realizohet në bashkëpunim me studio profesionale arkitekture dhe planifikimit urban dhe në koordinim të veprimeve midis Bashkive, MZHU dhe AKPT. PPV po hartohen bazuar në një metodologji që përfshin sistemet territoriale urbane, bujqësore, ujore, energjitike, dhe infrastrukturore. PPV do të sigurojnë : (i) koordinim me planet kombëtare, (ii) menaxhimin e integruar që mundëson planifikimin ndërsektorial, (iii) mbrojtjen e tokës.

34 Bashki gjithsej po punojnë për PPV. Brënda vitit 2016 do të kenë përfunduar PPV për 31 Bashki.. Planifikohet që **8 deri 10 Bashki** të tjera do të mbështeten nga MZHU për **hartimin e PPV në vitin 2017**.

Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave

Në kuadër të decentralizimit të plotë të funksionit të administrimit dhe menaxhimit të pyjeve dhe kullotave është hartuar baza ligjore⁴⁵ që mundësoi transferimin e funksionit, më specifikisht: (i) përgatitjen e inventarit të fondit pyjor dhe kullor sipas bashkive përkatëse, (ii) planin e shpërndarjes të transferimit, të personelit, aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe buxhetin përkatës dhe (iii) përgatitjen e aktive nënligjore për transferimin dhe rregullimin e ushtrimit

44. UNDP 2015 Progress Report Albania Chapter 2, fq 119

45. Urdheri i KM Nr.127, date 16.09.2016), pika 6, për funksionin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave" dhe VKM nr.438, date 08.06.2016 për "Kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor", VKM 435 date 08.06.2016 për disa shtesa dhe ndryshime të VKM 1374/2008 të KM "Për percaktimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", VKM 433 dt. 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, prone e MoE dhe ish komunave".

të funksionit nga bashkitë, si dhe VKM⁴⁶. Gjithashtu janë nxjerrë disa urdhëra dhe udhëzime të Ministrise së Mjedisit që përcaktojnë rregullat, procedurat dhe standartet për mireadministrimin e fondit pyjor dhe kullozor. Janë miratuar dy ligje të rëndësishme si ligji për "Administratimin e Fondit Pyjor dhe Kullozor në RSH" dhe ligji për "Shpalljen e Moratoriumit të gjuetisë në RSH"⁴⁷.

Me transferimin e funksionit në NJQV, **82.3% e sipërfaqes të fondit pyjor dhe kullozor ka kaluar në administrimin e Bashkive**, 15% e sipërfaqes i përket zonave të mbrojtura dhe 2.7% janë pyje private.

60% e burimeve njerëzore (**182 punonjës** të fondit pyjor nga 294 gjithsej) u transferuan në Bashki që nga data 1 Janar 2016. Gjithashtu u transferua, nga buxheti i shtetit, fondi përkatës për pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e transferuar.

Me qëllim sigurimin e menaxhimit efektiv të këtij funksionit nga Bashkitë ka disa sfida që mbeten për t'u adresuar:

o Bashkitë duhet të rrisin aftësitë për planifikimin e burimeve njerëzore dhe burimeve financiare për të siguruar mirëadministrimin dhe menaxhimin e fondit pyjor dhe kullozor, në kuadër të hartimit të buxhetit për 2017. Nevojat për burime njerëzore për funksionin janë llogaritur në afersisht 687⁴⁸ specialistë të pyjeve në nivel kombëtar.

o Bashkitë duhet të kryejnë rekrutimin e stafit teknik në përputhje me kriteret e përcaktuar në bazen ligjore (jo emërime politike).

o Regjistrimi i aseteve nuk ka filluar (proces kompleks). Rreth 40% e nevojave për regjistrimin e aseteve të fondit pyjor do të mbeshtetet nga projekti i BB për "Sherbimet Mjedisore", 2016-2020, nëpërmjet të cilit do të bëhet regjistrimi dhe unifikimi i regjistrit kadastral pranë ZRPP për fondin pyjor. Për pjesën tjetër (60%) të fondit pyjor, Bashkitë duhet të planifikojnë burimet e duhura nga fondet e veta për përfundimin e regjistrimit të aseteve.

Ende nuk ka progres në drejtim të rishikimit të funksioneve në fushën e rendit dhe mbrojtjes civile duke i përshtatur me ndarjen e re administrative.

(I) Sigurimi i cilësisë së shërbimeve sipas standardeve dhe politikave kombëtare; (ii) Rritja e efikasitetit të buxhetit kombëtar me qëllim që të sigurohet mbulimi i nevojshëm financiar për realizimin e standarteve të shërbimit sipas raporteve qendror/vendor dhe (iii) Eliminimi i kompetencave ndërmjet strukturave të dekoncentruara në nivel vendor dhe strukturave të qeverisjes vendore, janë tre sfidat kryesore të strategjisë.

Arsimi parauniversitar

Vendimi i Qeverise për decentralizimin e funksionit të arsimit⁴⁹ specifikon transferimin e personelit mësimor në arsimin parashkollor (kopshte) dhe personelin jomësimor në arsimin parauniversitar⁵⁰; Në kuadër të decentralizimit të këtij funksioni, 7101 punonjës u transferuan nën kompetencat e bashkive në vitin 2016 dhe ka përfunduar transferimi i dosjeve të personelit pranë bashkive. Transferimi i shërbimeve arsimore së bashku me numrin e punonjësve që ofrojnë këto shërbime është shoqëruar me efektet financiare prej 4.3 miliard lekë të miratuar me ligjin vjetor të

46. VKM 434 date 08.06.2016 "Per Percaktimin e rregullave dhe paraqitjes se kerkesave, mbajtjen e dokumentacionit teknik, si dhe te kriterëve e te procedurave te zvogelimit te sipërfaqes e te vellimit te fondit pyjor.

47. Ligji per "Administrimin e Fondit Pyjor dhe Kullozor ne RSH"; Ligji per "Shpalljen e Moratoriumit te Gjuetise ne RSH".

48. MeE ne perputhje me kerkesat e bazes ligjore te fondit.

49. Urdher i KM nr.127, date 16.09.2015 dhe VKM nr. 1102, date 28.12.2015 mbi "Perdorimin e fondeve publike për transportin e mësuesve dhe nxënësve të cilët ndjekin shkollën jashtë territorit të zonës së tyre të banimit".


50. për transferimin e numrin e punonjësve në arsimin parashkollor, edukatore në kopshtet e fëmijëve, numri e punonjësve të shërbimeve ndihmëse në arsimin 9-vjeçar ku përfshihet dhe numri i punonjësve të qendrave kulturore të fëmijëve, numri i punonjësve të shërbimeve mbështetëse në arsimin e mesëm të përgjithshëm "gjimnazet", si dhe fondet e parashikuara për mbulimin e shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore).

buxhetit⁵¹, ku përcaktohen se këta punonjës do të zbatojnë "Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi"⁵².

Në transfertën specifike të vitit 2016, disa bashkive i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar, si: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime. Ministria e Arsimit dhe Sportit para fillimit të vitit fiskal 2016, ka dërguar në njësitë e qeverisjes vendore gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me pagat dhe sigurimet shoqërore për konviktet e arsimit parauniversitar. Njësitë e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor, edhe pse nga ana e këtyre të fundit ka ende pretendime që fondet që vijnë nga qeveria qendrore për zbatimin e këtij funksioni duhet të jenë më të mëdha.

Bashkitë duhet të mirë koordinojnë veprimet me MeF dhe MAS në rastet e hapjes së njësive të reja lidhur me numrin e punonjësve dhe fondet e nevojshme në kuader të planifikimit të buxhetit për vitin pasardhës. Kujdes duhet bërë për përdorimin e fondit të vecantë i cili tashme menaxhohet nga Ministria e Financave.

Grafiku 16 : Investime ne Infrastrukturen Shkollore sipas Qarqeve, 2016
në milion lekë



Burimi: MAS

Në vitin 2015 janë kryer 1,131.8 *Milion Leke* investime në shkallë vendi⁵³, përkatësisht në 4 ndërtesa të reja, 44 rikonstruksione dhe 44 terrene sportive dhe palestra. Ndërsa niveli i investimeve në infrastrukturen shkollore për vitin 2016 është 2,370.4 *Milion leke*.

51. Ligji nr.147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016";

52. Reference aneksi 4 i Ligjit nr.147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016"

53. Për investime në infrastrukturen shkollore sipas nevojave të tyre (ndërtime të reja dhe rikonstruksione të ndërtesave ekzistuese), Bashkitë aplikojnë nepermjet MAS ne Fondin e Zhvillimit te Rajoneve.



Progres i rëndësishëm është shënuar në drejtim të hartimit të kuadrit strategjik e ligjor lidhur me zbutjen e varfërisë, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen sociale. Strategjia e Përfshirjes Sociale⁵⁴, e cila u miratua në dhjetor të vitit 2015, përcakton qartë politikat e këtij sektori në nivelin vendor. Si objektiva të rëndësishëm që lidhen me qeverisjen vendore, strategjia përcakton:

1. Ngritjen e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore në zonat e përzgjedhura deri më 2017 dhe në nivel kombëtar deri më 2020;

2. Rishikimin e funksioneve të planifikimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për nivele të ndryshme të qeverisjes vendore dhe modele të reja në zbatim deri më 2017.

Draft ligji për shërbimet shoqërore është në proces miratimi dhe pritet që të realizohet brenda vitit 2016. Me miratimin e ligjit do të hartohet edhe lista specifike e shërbimeve sociale që do të ofrohen nga NJQV duke prezantuar dhe shpjeguar tipologjinë e shërbimit të ri. Më tej do të vazhdohet me hartimin dhe miratimin e standardeve të shërbimeve dhe kostove për njësi. Është në proces hartimi modeli/tipi i rregullores së përshkrimeve të punës për punonjësit socialë, kompetencat e nevojshme dhe aftësitë që kërkohen.

Mbrojtja e mjedisit

Gjatë kësaj periudhe, fokusi është përqëndruar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore për mbrojtjen e mjedisit. Trainimi i specialistëve në pushtetin vendor për zbatimin e ligjit për lejet mjedisore, aspekte të ndryshme të administrimit të mjedisit, programet e zhvillimit dhe trainimi për çështjet e mjedisit, për legjislacionin mjedisor, është një kusht i detyrueshëm për të gjithë nëpunësit civilë që punojnë në strukturat e NJQV-ve, të cilat janë përgjegjëse direkt për menaxhimin e mjedisit. Gjatë vitit 2016, SHAP po vijon trainimin e nëpunësve civil të bashkive për çështje të menaxhimit të integruar të mbetjeve (planifikim vendor në menaxhimin e mbetjeve, financimi i shërbimit, sistemi i performancës, komunikimi) përmes kursit 1-vjeçar të trainimit, në të cilin marrin pjesë zyrtarë nga 48 Bashki.

Gjatë vitit 2017, do të përmirësohet sistemi i grumbullimit të të dhënave të sektorit dhe do të fillojë aplikimin e sistemit të benchmarking, fillimisht në disa bashki në veri të Shqipërisë dhe më pas do të vijohet me cikël trainimesh për rritjen e kapaciteteve të bashkive për sistemin e benchmarking në të gjithë vendin.

Me synim rritjen e burimeve financiare të NJQV-ve për funksionin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e një sistemit integral të përcaktimit të kostove dhe tarifave për trajtimin e mbetjeve, Ministria e Mjedisit, me asistencën e projektit dldp ka paraqitur gjatë muajit Qershor 2016 draft VKM-në "Per kostot dhe tarifat e menaxhimit të integruar të mbetjeve". Me anë të këtij vendimi do të mundësohet përdorimi i një metodologjie të perlllogaritjes së kostos dhe tarifave për menaxhimin e mbetjeve. Miratimi i VKM për kostot dhe tarifat e menaxhimit të mbetjeve, do të ndiqet nga trainimi nëpërmjet SHAP-s i zyrtarëve të 61 bashkive për modelin e kostos dhe tarifës. Aplikimi i modelit të kostos dhe tarifës ka filluar në 6 bashki, të cilat do të përdorin këtë metodologji gjatë hartimit të buxhetit dhe paketës fiskale në vitin 2017.


Funksionet e tjera

Rritja e efikasitetit të buxhetit kombëtar, është një domosdoshmëri për të siguruar mbulimin e nevojshëm financiar për realizimin e standardeve të shërbimit⁵⁵. Si edhe përmendet më lartë Ligji i ri për kujdesin shoqëror, i cili pritet të miratohet, do të përcaktojë edhe

54. Vendim, Nr. 1071, Datë 23.12.2015, "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015–2020" dhe të Planit të Veprimit, për zbatimin e saj"
55. Objektivi Specifik III.2.1

ndryshimet përkatëse të strukturave të NJQV për të siguruar një qasje të integruar dhe një planifikimi të ofrimit të shërbimeve të harmonizuara sociale dhe përfshirjes sociale. Është hartuar plani për deinstitutionalizimin e shërbimeve nga modeli i vendit të banimit në shërbime me bazë komunitare dhe familjeje, Godinat e 18 qendrave të përkujdesit social (nga 28 në total), janë transferuar pranë bashkive, të cilat janë përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe kryerjen e investimeve, ndërsa MMSR/dhe MeF transferon fondin nga buxheti i shtetit sipas organikave (për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative) në qendra e përkujdesit social nëpërmjet sistemit të Thesarit.

Grafiku 17: Tranferta per Qendrat e Kujdesit Social dhe Bursa (2015-2016)
në milion lekë



Të dy nivelet e qeverisjes (MMSR/Sherbimi Kombëtar Social) dhe Bashkitë kanë rol dhe përgjegjësi për monitorimin e shërbimeve të ndryshme sociale sipas standardeve të miratuara dhe rregulloreve përkatëse. Numri i punonjësve në 28 qendrat e kujdesit social është 335 (ose 11.1% i numrit total të punonjësve publikë të punësuar në sektorin social).

Eliminimi i mbivendosjes së kompetencave ndërmjet strukturave të dekoncentruara në nivel vendor dhe strukturave të qeverisjes vendore, është një ndër objektivat specifike të strategjisë. Rishikimi i Ligjit për prefektin i cili ka kaluar për miratim në Qeveri ka për qëllim qartësimin e statusit dhe rolit të prefektit për të shmangur mbivendosjet. Ligji pritet të miratohet nga Kuvendi brenda vitit 2016.


4.4 Progresi i arritur në drejtim të Forcimit të Qeverisjes së Mirë në Nivelin Vendor dhe Zbatimit të të Drejtave të Qytetarëve

Në kuadër të këtij aktiviteti, në vitin e parë të zbatimit të strategjisë gati 60% e aktiviteteve, ose në total 32 nga 54 aktivitete kanë filluar të zbatohen dhe 18 prej tyre janë realizuar gjatë 2016?, por një pjesë e mirë e tyre janë planifikuar të fillojnë gjatë vitit 2017 (shih grafikët me poshte).


Progres më i mirë vihet re në realizimin e aktiviteteve që lidhen më arritjen e objektivit strategjik të **Zhvillimit të kapaciteteve të njësive të qeverisjes, ku është parashikuar edhe numri më i madh i aktiviteteve për këtë qëllim strategjik**. Në kuadër të këtij objekti janë realizuar 17 aktivitete. Ndërkohë paraqiten më vonësë në fillimin e tyre 5 aktivitete⁵⁶.

56. 61 bashkitë janë trajnuar për procedurat e riorganizimit administrativ; NJQV-ve që kanë lidhur sistemin HRMIS me sistemin e thesarit; rishikimi i akteve ligjore, marrveshjet e bashkëpunimit me dhomat e tregëtise dhe ngritja e databazes elektronike.

Grafiku 18: Shkalla e Realizimit të aktiviteteve në total për Qëllimin Strategjik – IV (në numër dhe %)



Grafiku 19: Shkalla e Realizimit të Aktiviteteve sipas Objektivave Strategjike (në numër)



Objektivi Strategjik: Zhvillimit të kapaciteteve të njësive të qeverisjes


Fuqizimi i administratës vendore është qëllimi kryesor në ecurinë e reformës së administratës publike në nivel vendor. Prioriteti i qeverisë është të krijojë një administratë publike të paburokratizuar, profesionale dhe transparente, politikisht të paanshme, të aftë për t’iu përgjigjur pritshmërive të biznesit dhe komunitetit për shërbimet publike, e gatshme për t’iu përgjigjur sfidave të integritimit evropian të vendit dhe thithjes së fondeve të BE, në respekt të plotë të standardeve, si prioritet kryesor i kësaj reforme. Ligji Nr 139/2015 sjell një qartësim më të madh të roleve dhe ndarjes së tyre, kompetencat dhe procedurat përkatëse lidhur me bashkëpunimin ndërvendor për zbatimin e funksioneve përkatëse, duke fuqizuar në këtë mënyrë organet e qeverisjes vendore. Qeveria aprovoi në mars të vitit 2016 VKM nr. 165, datë 2.3.2016 për nivelin e ri të pagave të administratës vendore⁵⁷.

Rritja e kapaciteteve institucionale të bashkive të reja me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike ka qënë një ndër synimet e aktiviteteve në këtë fazë të parë të zbatimit të strategjisë. Është ofruar mbështetja financiare për zbatimin e procesit të ngritjes së strukturave të MBNJ në bashkitë e reja, si dhe është ofruar asistencë teknike nga MSHCV, AZRT dhe projekti STAR për ngritjen e strukturave të reja. Programi i KiE për burimet njerëzore do të asistojë në vijim në mënyrë më specifike në këtë drejtim.

Progres i ndjeshëm është arritur në drejtim të sigurimit të një sistemi menaxhimi të efektshëm të burimeve njerëzore për administratën vendore, por ende mbeten hapa të rëndësishme për t’u ndërmarrë. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial⁵⁸, përcaktoi qartë rregullat

57. VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/38-2016.pdf

58. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/103-2015.pdf



dhe afatet lidhur me transferimin e personelit dhe asetëve pranë bashkive të reja. MSHCV dhe AZRT kanë nxjerre “Udhëzuesin praktik për transferimin e stafit pas zgjedhjeve vendore në 21 qershor 2015”, për t’u ardhur në ndihmë NJQV për kryerjen e këtij procesi në mënyrë sa më korrekte. Përcaktimi i niveleve të reja të pagave mundëson rritjen e autonomisë së të zgjedhurve vendorë, për përcaktimin e niveleve shtesë të pagave, nëpërmjet zëvendësimit të kriterëve statike të tavanëve limit të pagave me sistemin dinamik të treguesve të performances.

Ka përfunduar përgatitja paraprake e strukturave tip (blue print) për administratën bashkiake si dhe modelit të përshkrimeve të vendeve të punës. Projekti STAR ka hartuar 61 struktura me përshkrimin e vendeve të punës. Këto struktura të propozuara u janë dorëzuar bashkive për shqyrtim. Projekti i KiE ofroi gjithashtu dy modele strukturash për tu përdorur gjatë procesit të bashkimit të bashkive. Po kështu nëpërmjet sistemit E-PAV u ofrua një model strukture për tu marrë në konsideratë gjatë procesit të diskutimit dhe miratimit të strukture nga kryetari i bashkisë. Struktura model - standarte e krijuar në sistem lejon adaptimin e cdo modeli-strukture të aprovuar me ndihmën e aktorëve të tjerë. Struktura e krijuar në sistem për ato pozicione që kanë përcaktime të kriterëve ligjore vendos elemente kontrolli gjatë shpërdarjes së punonjësve në sistem, duke paralajmëruar në këtë mënyrë Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (MBNJ) për mospërputhjen dhe mundëson gjenerimin e raporteve për rastet që nuk përmbushin kriteret ligjore.

Ka pasur ecuri në drejtim të zbatimit të vlerësimit periodik të zbatimit të Ligjit të Sherbimit Civil dhe procedurave përkatëse. Ky vlerësim që pritet të përfundojë brenda vitit 2016 realizon vlerësimin e parë të zbatimit të ligjit pas reformës administrativo-territoriale.

Nuk ka ende progres në drejtim të bërjes operacionale të sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) dhe lidhjes së tij me Sistemin e Menaxhimit Financiar Qëndror (Thesarin), me qëllim monitorimin e zbatimit të legjislationit të sherbimit civil dhe sistemit të pagave në nivelin vendor.

Ka vijuar mbështetja ndaj bashkive për ngritjen e kapaciteteve për realizimin e vlerësimeve të punës nga NJQV. DAP ka hartuar manualët dhe udhëzimet për vlerësimin e punës dhe sistemin e klasifikimit të vendeve të punës i dedikuar për NJQV. Është mbajtur trajnimi për vlerësimin e arritjeve në punë për stafet e NJMBNJ të bashkive dhe në muajin nëntor 2016 projekti i KiE do të ofrojë një trajnim të avancuar, me qëllim që të mundësohet kryerja e vlerësimit të arritjeve në punë në fund të vitit 2016. Nëpërmjet sistemit E-PAV do të mundësohet ofrimi i të dhënave mbi numrin e punonjësve që kalojnë procesin e vlerësimit deri në fund të muajit qershor 2016 si dhe të paraqiten rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Ecuri pozitive, shënohet në drejtim të vlerësimit të nevojave për training dhe hartimit të planit kombëtar të trainimeve. Është realizuar vlerësimi kombëtar institucional i nevojave për training për administratën vendore. Ky vlerësim është një proces që ndodh në vijimësi të zbatimit të procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore në zbatim të Ligjit për Nënpunësin Civil 152/2013 i amenduar, i cili siguron që të dhënat e punonjësve të azhurnohen në vijimësi sa i përket zhvillimit të karrierës, nevojave për training dhe marrjes së trainimeve nga SHAP. Është duke u zhvilluar metodologjia Vlerësimit të Nevojave të Trajnimit për të mbështetur performancën e funksioneve të reja të transferuara NJQV. Metodologjia e VNT bazohet në vlerësimin sipas kompetencave për cdo funksion dhe është e lidhur me vlerësimin e arritjeve në punë. Aktualisht po zhvillohet një proces konsultimi ndërmjet MIAP, MCV dhe DAP e SHAP për rregullimin formal të procesit të VNT në

administratën vendore për të vendosur një standart të unifikuar të zbatueshëm në nivel vendor

Pavarësisht këtij vlerësimi fillestar, vlerësimi i nevojave për trainim do të kryhet periodikisht i lidhur me procesin e vlerësimit të arritjeve në punë cdo mes dhe fund viti në përputhje me Ligjin për nëpunësin civil 152/2013, i amenduar. Gjithashtu, sistemi E-PAV (Platforma Elektronike për Administratën Vendore) mundëson ndërveprimin midis NJQV, MSHCV dhe SHAP për finalizimin e planit të trainimeve që do të ofrohen nga SHAP si dhe mundëson koordinimin e trainimit ndërmjet ofruesve të tjerë/projekte/agjenci nga MSHCV. Ky sistem njëkohësisht ofron mundësinë e koordinimit dhe organizimit të trainimit.

Në vijim të vlerësimit të nevojave për trainim po punohet për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Trainimit për administratën vendore 2016-2019.

Gjithashtu në kuadër të VKM 510, dt.10.6.2015 është aprovuar akti ligjore lidhur me trajtimin gjatë periudhës së tranzicionit të stafit që rezulton i tepërt.

Ka filluar dhe po zbatohet me sukses ngritja dhe trainimi fillestar i NJBNJ në çdo administratë të re bashkiake, si njësi që do të përgatisin dhe realizojnë procesin e tranzicionit. Janë zhvilluar 3 trainime të posacme të të gjithë përfaqësuesve të NJBNJ në 61 bashkitë e reja (në total 194 persona), respektivisht për cështjet e bashkimit e shkrirjes së njësisive vendore, cështjet e rekrutimit/marrjes në punë dhe cështjet e vlerësimit të arritjeve në punë. Projekti KiE, deri në fund të vitit 2016 do të ofrojë trainim për NJBNJ për cështjet e vlerësimit të arritjeve në punë të lidhura me vlerësimin e nevojave për trainim. Sapo sistemi HRMIS të jetë operacional për NJQV, do të ofrohet trainimi i tyre për sistemin nga projekti si dhe në vijimësi deri në qershor 2017.

NJQV do të vazhdojnë të trainohen edhe në 2017-2018. SHAP ka miratuar 2 programe 1 vjecare trainimi të vazhduar për vitin 2016 në fushat e: 1) Menaxhimit të Mbetjeve Urbane dhe 2) Menaxhimit të Financave Publike. Dldp është në proces të vlerësimit të cilësisë së kurrikulës së trainimit për ofrimin e shërbimeve administrative ndërmjet Zyrave me Nje Ndalese. Gjatë kësaj periudhe është ofruar trainimit hyrës për të gjithë shërbyesit civilë të zhvendosur (për bashkitë e reja), të cilët nuk kanë kaluar nëpër trainimin e ofruar nga Shkolla e Administratës Publike. Janë trainuar nga SHAP 324 nëpunës civilë në vitin 2015 dhe 226 për vitin 2016. Në vitin 2017, SHAP do të ofrojë një program trainimi për të gjitha bashkitë për shërbimet dhe procedurat administrative që duhet të ofrohen me anë të IOSSH⁵⁹.

Kutia 2: Të dhëna mbi trajnimet e kryera nga ASPA (Janar 2015 - Shtator 2016)

- o NC 1,150 ne total
- o Numri total i diteve te trajnimeve: 216
- o Numri total i kurseve te trajnimit: 50

Te detajuara sipas periudhave si me poshte:

Per vitin 2015 jane trajnuar:


- o 755 punonjes me statusin e nepunesit civil
- o 132 dite trajnimi
- o 29 kurse trajnimi

Janar - Qershor 2016 jane trajnuar:

- o 251 punonjes me statusin e nepunesit civil
- o 65 dite trajnimi
- o 13 kurse trajnimi

Qeshor 2016 - 30 Shtator 2016 jane trajnuar:

- o 144 punonjes me statusin e nepunesit civil
- o 19 dite trajnimi
- o 8 kurse trajnimi



Po vijon puna për ngritjen e ekipit kombëtar të trajnerëve dhe rrjetit të menaxherëve të NJMBNJ, të aftë për të replikuar dhe në dhënien e programeve të veçanta të trainimit dhe të moduleve në zbatimin e legjislacionit të SHC. Eshtë krijuar grupi i trainerëve, të certifikuar nga projekti i KiE, për menaxhimin e burimeve njerëzore. Janë identifikuar përfaqësues të NJMBNJ të NJQV të aftë për të ofruar trainime për çështje të MBNJ për kolegët e tyre. Nëpërmjet sistemit E-PAV - rrjeti i MBNJ të 61 bashkive dhe 12 këshillave të qarqeve i krijuar dhe funksional nëpërmjet trainimeve ka mundësinë të funksionojë edhe virtualisht nëpërmjet sistemit në menyrë të vazhdueshme. Unifikimi i sistemit, i procedurave, unifikimi i interpretimeve ligjore dhe i praktikave nëpërmjet help desk të krijuar tek DAP dhe E-PAV, e mbajnë rrjetin e MBNJ aktiv dhe të azhurnuar me të rejtat në fushën e MBNJ. Ekipi i trainerëve dhe rrjeti kombëtar i MBNJ të NJQV do të vijojë të forcohet përmes mjeteve të krijuara për trajnime, E-PAV, njoftimeve elektronike për çështje të MBNJ, FAQ në faqen e E-PAV.

Po hidhen bazat për krijimin e një sistemi detyrues (procedural dhe institucional) për të siguruar koordinimin dhe certifikimin e aktiviteteve të trainimit të ofruara nga donatorët nëpërmjet SHAP: SHAP po zbaton testimin dhe certifikimin për punonjësit e bashkive që ndjekin programet e trainimit të mbështetura nga donatorë të ndryshëm. Kjo mundëson koordinimin më të mirë të donatorëve në rastet e mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve.

Progres është arritur në krijimin e arkivës dhe librarisë elektronike të materialeve të trainimit për qeverisjen vendore. Po punohet për vendosjen e sistemit të cilësisë për kurrikulën dhe trainerët. Janë duke u përgatitur standartet dhe kriteret për sistemin e vlerësimit të cilësisë së kurrikulave dhe trainerëve. Në vitin 2017 do të përfundojë platforma " e-Library" me kurrikulat që kanë kaluar procesin e vlerësimit të cilësisë. SHAP ka publikuar një katalog të materialeve për trainimin e punonjësve të qeverisjes vendore dhe brenda vitit 2016 do të vlerësojë një pjesë të kurrikulave ekzistuese. Gjithashtu sistemi E-PAV mundëson aksesin në arkivën e materialeve të trainimit për çështjet e MBNJ.

Objektivi Strategjik: Sigurimi i një qeverisje të hapur, rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe shtrirjes më të madhe të e-qeverisjes në nivelin vendor.

Ky është një tjetër objektivi i rëndësishëm i strategjisë ku aktivitetet kanë filluar të zbatohen, sidomos në drejtim të rishikimit të kuadrit ligjor dhe sistemeve të llogaridhënies e transparencës. Me ndihmën e projektit të Binjakëzimit, financuar nga Bashkimi Europian, DAP po realizon vlerësimin dhe rishikimin e legjislacionit të veçantë që ka të bëjë me procedimin administrativ të veçantë nën juridiksionin e NJQV-së, në funksion të sigurimit të përputhjes së tyre me Kodin e ri të Procedurës Administrative.

Vlerësimi i mundësive për përdorimin e teknologjise së informacionit në shërbimet publike lokale ka filluar dhe pritet të finalizohet brënda vitit 2016. Ky vlerësim bazohet mbi analizën e kuadrit ligjor dhe vetëvlerësimin e 61 bashkive dhe 12 këshillave të qarqeve, për sa i përket sigurimit të transparencës në vendimmarrje dhe llogaridhënies në procesin e qeverisjes vendore. Vlerësimi përfshin gjithashtu mjetet përdorura, përfshirë dhe ato të ICT. Ky vlerësim ka për qëllim të krijojë një hartë të situatës aktuale, si dhe të aktorëve të përfshirë dhe nevojave të prezantuara nga NJQV. Ky vlerësim do të shërbejë edhe si bazë për dizajnimin e mëtejshëm të asistencës bazuar në nevojat e tyre. Aktualisht 59 bashki dhe 10 këshilla qarqesh kanë dorëzuar pyetësorët. MSHCV do të vijojë punën për krijimin e mjeteve standarte të sigurimit të

transparencës, marrjes së opinionit qytetar për cilësinë e shërbimeve, sigurimin e llogaridhënies si dhe ngritjen e kapaciteteve.

Ende nuk ka progres në drejtim të krijimit të Databazës elektronike për aktet ligjore dhe nënligjore që afektojnë qeverisjen vendore dhe forcimin e bashkëpunimit midis NJQV dhe dhomave të tregtisë.

Menaxhimi i dokumenteve dhe arkivimi ka qenë një nga mangësitë kryesore të administratave lokale. Me ndihmën e projektit STAR, bashkitë e Urës Vajgurore dhe Pogradecit janë marre si bashki pilote për të bërë vlerësimin, dhe për të hartuar një model për adresimin e këtij problemi. Sistemi është pilotuar në korrik të vitit 2015. Në fund të vitit 2015 u krye analiza e situatës në nivel lokal, e cila lejon hapjen e mundësisë për të trajtuar çështjen nëpër bashkitë e tjera në të ardhmen.

Progres i mirë është bërë në drejtim të krijimit të lehtësirave për qytetarët për marrjen e informacionit dhe shërbimeve. Pranë "njësive administrative" vazhdon krijimi i sporteve unike ose "one stop shop", për t'u marrë me të gjitha procedurat dhe formalitetet nën kompetencë të bashkive. Janë krijuar "one stop shop" në 5 bashki pilot Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Korçë⁶⁰, si dhe në 2016 përfundon ngritja edhe e 7 sporteve unike në 7 njësi administrative (5 në Shkodër dhe 2 në Lezhë) dhe në vitin 2017, 11 sporte unike në 11 njësitë administrative të Matit dhe Klosit (7 në Mat dhe 4 në Klos).

ADISA ka në fokus momentalisht 420 shërbime për 10 institucione⁶¹. Shtrirja e Qendrës së ofrimit të Shërbimeve Publike – ADISA nga aktualisht 2 qendra : Tiranë dhe Kavajë, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2017 do të vazhdoje me hapjen edhe të 3 qendrave të tjera të këtij lloji në Fier, Krujë dhe Gjirokastrë.

E-Lejet është Platforma elektronike për aplikimin, pranimin dhe shqyrtimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit

është një nismë e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Agjencië Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) i cili mundëson aplikimin elektronik për leje në fushën e ndërtimit në të gjithë territorin e vendit. Prej dates 1 Shtatori 2016 çdo qytetar apo biznes duhet të aplikojë nëpërmjet portalit e-Albania për t'u pajisur me leje ndërtimi. Sistemi mundëson monitorimin e afateve të aplikimit dhe shqyrtimit të aplikimeve për leje.



Njësitë e reja kanë bërë progres lidhur me ofrimin e informacionit me publikun, por ende nuk është arritur që ligji për të drejtën e informimit të realizohet sipas gjithë kërkesave të ligjit. Komunikimi me qytetarët nëpërmjet përdorimit të mjeteve të informacionit dhe medias sociale ka qënë një objektiv i rëndësishëm për administratat e reja vendore, por edhe ato ekzisutese. Komunikimi me qytetarët nëpërmjet përdorimit të mjeteve të informacionit dhe medias sociale ka qënë një objektiv i rëndësishëm për administratat e reja vendore, por edhe ato ekzisutese. Ka vijuar me krijimin e faqeve të internetit në qarqe dhe 61 bashkitë. Aty ku nuk ka qënë e mundur krijimi i faqeve të internetit, është shfrytëzuar përdorimi i facebook, si një media e re sociale e komunikimit me qytetarët. Aktualisht, sic paraqitet edhe në tabelën e mëposhtëme, 36 bashki dhe 10 qarqe kanë tashmë faqet e tyre të internetit për publikimin e aktivitetit të këtyre njësive.

60. Me mbështetjen e Programit DLDP,

61. 1. Qendra Kombëtare e Biznesit, 2. Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit, 4. Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, 5. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, 6. Drejtorja e Përgjithshme Detare, 7. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, 8. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, 9. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, 10. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Tabela 3: **Adresat e Faqeve të internetit për Bashkitë dhe qarqet**

Nr.	Qarku	Adresa e Këshillit të Qarkut në web	Bashkia	Adresa e Bashkisë në Web
1	Berat	garkuberat.gov.al	Berat	bashkiaberat.gov.al
			Ura Vajgurore	
			Kuçovë	bashkiakucove.gov.al
			Skrapar	bashkiacorovode.gov.al
			Poličan	polican.gov.al
2	Dibër	www.garkudiber.gov.al	Dibër	peshkopia.com
			Bulqizë	
			Mat	bashkiamat.gov.al
			Klos	
3	Durrës	www.garkudurres.gov.al	Durrës	durres.gov.al
			Shijak	
4	Elbasan	www.garkuelbasan.gov.al	Krujë	kruja.gov.al
			Elbasan	elbasani.gov.al
			Cërrik	
			Belsh	
			Peqin	
			Gramsh	bashkiagramsh.gov.al
			Librazhd	
5	Fier	www.garkufier.gov.al	Prrenjas	
			Fier	bashkiefier.gov.al
			Patos	bashkiapatos.gov.al
			Roskovec	bashkiaroskovec.gov.al
			Lushnjë	bashkialushnje.gov.al
			Divjakë	bashkiadivjake.wordpress.com
6	Gjirokastrë		Mallakastër	
			Gjirokastrë	gjirokastra.org
			Libohovë	
			Tepelenë	bashkiatepelene.com
			Memaliaj	
			Përmet	bashkia-permet.wix.com/bashkia
			Këlcyrë	
7	Korçë	www.korcaregion.com	Dropulli	bashkiadropull.com/sq/
			Korçë	bashkiakorce.gov.al
			Maliq	
			Pustec	
			Kolonjë	
			Devoll	bashkiadevoll.al
			Pogradec	bashkiapogradec.al
8	Kukës	www.kgk.gov.al	Kukës	kukesi.gov.al
			Has	
			Tropojë	
9	Lezhë	www.garkulezhe.gov.al	Lezhë	lezha.gov.al
			Mirditë	bashkiamirdite.gov.al
10	Shkodër	www.garkushkoder.gov.al	Kurbín	
			Malësi e Madhe	
			Shkodër	bashkiashkoder.gov.al
			Vau - Dejës	vaudejes.gov.al
			Pukë	bashkiapuke.gov.al
11	Tiranë	www.garkutirane.gov.al	Fushë - Arrëz	
			Tiranë	tirana.gov.al
			Kamëz	kamza.gov.al
			Vorë	bashkiavore.gov.al
			Kavajë	bashkiakavaie.gov.al
12	Vlorë		Rrogzhinë	
			Vlorë	bashkiavlore.org
			Selenicë	bashkiaselenice.org
			Himarë	himara.gov.al/himara
			Sarandë	bashkiasarande.gov.al
			Konispol	
			Finiq	
			Delvinë	



Në 42 bashki është caktuar koordinatori i informimit (ose 68.8% e tyre) ndërsa **publikimi i vendimeve të këshillave bashkiake bëhet vetëm nga 14 bashki** (ose 22.95%)⁶².

Me mbështetjen e projektit Lëviz Albania, janë kryer monitorime të ndryshme lidhur me zbatimin të ligjit për të drejtën e informimit.

62. Sipas të dhënave të Komisionarit për të Drejtën e Informimit



Objektivi Strategjik: Integrimi Evropian dhe qeverisja vendore

Një vemendje e rëndësishme i jepet forcimit të rolit të qeverisjes vendore në procesin e integritit evropian. Ky rol kërkon së pari që kapacitetet e bashkive të reja në drejtim të përfhsirjes së tyre me sukses në menaxhimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian. Ministria e Integritit Evropian ka organizuar një sërë ditësh informuese në kuadër të thirrjeve për propozime të shpallura në muajt maj-korrik 2016 për programet e bashkepunimit ndërkufitar me Malin e Zi dhe Greqinë. Në këto ditë informuese kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të bashkive të cilat përfitojnë nga këto programe. MIE ka zhvilluar në Korrik 2016, një sesion informues me 12 Bashki që përfitojnë nga Programet IPA CBC dhe që mbështeten nga projekti DLDP. Në këto sesione kanë marrë pjesë stafëve - financa, planifikimi, sektori IT, shërbimet, anëtare femra të këshillave bashkiake), mbi kuadrin e projekteve IPA II, IPA CBC.

PLGP/USAID ka organizuar një sesion trajnimi 5 ditor me bashkitë Korç, Fier, Lushnje, Kuçovë, Berat, Patos, Vorë, Shkodër, Vau i Dejes, Ersekë, për menaxhimin e fondet IPA, në fund të të cilit çdo bashki realizoi projektpropozime për plane konkrete të tyre.

Gjithashtu në kuadër të rritjes së kapaciteteve të shoqërisë civile dhe administratës vendore, në kuadër të projektit “Rritja e pronësisë lokale për integrimin evropian përmes riorientimit të debatit dhe fuqizimit të kapaciteteve të shoqërisë civile për përvetësimin e fondeve të BE”, të të financuar nga OSFA/Fondacioni Soror, në periudhën Gusht – Dhjetor 2015 u realiu programi i trajnimit për 4 rajonet kryesore të Shqipërisë Shkodra, Vlora, Gjirokastra dhe Korça të cilat kanë përfituar gjerësisht nga fondet e IPA CBC, duke targetuar drejtpërdrejt edhe përfaqësuesit e pushtetit vendor të këtyre rajoneve në nivel qarku, bashkie. Trajnimet synonin të plotësonin nevojën imediate për të ofruar një informacion të përgjithshëm në lidhje me funksionimin e mekanizmave financiare të BE-së për Shqipërinë, nga cilat burime financimi përfiton Shqipëria dhe shembuj konkret të programeve konkrete nga e cila përfitonin rajonet përkatëse: Gjirokastra, Vlora, Korça dhe Shkodra. Në trajnimet pati një pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha bashkitë e rajoneve dhe një interes të madh sidomos nga bashkitë e vogla të cilat nuk kishin marrë asnjëherë më parë të tilla trajnime. Trajnimet u organizuan në bashkëpunim me SHPA-n duke siguruar një pjesëmarrje maksimale jo vetëm nga bashkitë, por edhe qarqet e prefekturat. Në këto trajnime morren pjesë rreth 94 pjesëmarrës.


5. Aktivitetet kryesore deri në fund të vitit 2016



Ndërkohë që vazhdon puna për zbatimin e nje sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e veprimit, ne katër muajt e ardhshëm, deri ne fund të vitit 2016 pritet të realizohen aktivitetet e mëposhtëme:

- Rishikimi i Ligjit për prefektin me qëllim qartësimin e statusit dhe rolit të prefektin për të shmangur mbivendosjet.
- Përfundimi i projektligjit për Financat e Vetëqeverisjes Vendore dhe i paketës së trainimeve përkatëse;
- Përfundimi i hartimit të Planit Kombëtar të Trajnimit të Njësive të Qeverisjes Vendore
- Miratimi i VKM për përcaktimin gjeografik i kufijve administrative i 61 bashkive
- Ngritja e Këshilli Konsultativ dhe bashkëpunimi me shoqatat vendore.
- Rishikimi i ligjit të strehimit social
- Realizimi i 1 konference dhe 4 seminareve rajonale për rolin e qeverisjes vendore në procesin e integritit ne BE.

Miratimi i ligjeve të mësipërme do ti hapi rrugë zbatimit të reformave të mëtejshme dhe programeve të mëtejshme të mbështetjes së bashkive dhe njësive administrative.



6. Metodologjia e Monitorimit dhe Raportimit

SKNDQV 2015-2020 përcakton se zbatimi i strategjisë do të shoqërohet me një proces monitorimi të vazhdueshëm me qëllim që të sigurohet arritja e objektivave të parashikuara. I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit udhëhiqet në nivel politik nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore.


Strategjia përfshin dy instrumenta kryesorë monitorimi dhe vlerësimi:

1. Plani i Veprimit i Zbatimit të SKNDQV 2015-2020, i cili shërben për monitorimin e arritjeve dhe të ecurisë në proces, përmes matjes së veprimeve dhe rezultateve brenda kohës së programuar. Plani i Veprimit përfshin gjitha komponentët, me objektiva specifike, veprimet e parashikuara, afatet kohore, kushtet dhe përgjegjësitë për zbatimin e tij.

2. Matrica e Treguesve të Performancës e cila përfshin treguesit bazë që do të përdoren për monitorimin e performancës dhe arritjeve të politikave në fusha të ndryshme, si politika fiskale, reforma territoriale-administrative, etj.

Monitorimi i strategjisë parashikon kryerjen e procesit të monitorimit në nivel tre shkallësh realizimin e tij në tre afate kohore të caktuara:

Figura 1: Niveli mesatar kombëtar i transparencës në qeverisjen lokale




Ky raport monitorimi fokusohet në analizën e shkallës së realizimit, apo përbushjës së aktiviteteve duke paraqitur analizën e realizimit për periudhën e parë një-vjeçare të zbatimit të aktiviteteve të planifikuara.

Treguesit e performancës nuk janë objekt i matjes dhe raportimit, pasi matja e tyre do të realizohet gjatë vitit 2017 që përkon edhe me periudhën afatmesme të vlerësimit të arritjeve të strategjisë.

Grumbullimi i të dhënave

Proçesi i mbledhjes së informacionit filloi në muajin Qershor 2016 dhe përfundoi në muajin Gusht 2016. Procesit i mbledhjes së informacionit, monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë u koordinua nga Kabineti i Ministrisë të Shtetit për Çështjet Vendore i cili do të kryejë rolin e koordinatorit ndërsektorial të procesit të zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë. Një kontribut të rëndësishëm në ofrimin e informacionit ofruan ekipet e projekteve që mbështesin zbatimin e reformave në fushën e qeverisjes vendore: Programi për Zhvillim Vendor dhe Decentralizim, Projekti për Qeverisjen Lokale/USAID, Projekti i Këshillit të Europës dhe Projekti STAR. Veç informacionit të mbledhur nga burimet e mësipërme të informimit, u shfrytëzuan një sërë të



dhënash të grumbulluara nëpërmjet informacioneve të publikuara në faqet e internetit të ministrive të ndryshme dhe agjensive qendrore. Gjithashtu, u shfrytëzuan edhe raportet e monitorimit të hartuara në kuadër të strategjive të tjera sektoriale të cilat përfshinin aktivitete të cilat lidheshin me funksionimin dhe aspektet e ndryshme të qeverisjes vendore. Një burim i rëndësishëm informacioni u shfrytëzuan dhe raporte monitorimi të shoqërisë civile apo organizatave ndërkombëtare që operojnë në vend. Gjithashtu nëpërmjet ekspertëve të kontraktuar nga Programi Dldp, një sërë intervistash u realizuan me përfaqësues të ndryshëm të ministrive të linjës.

Kriteret e vlerësimit

Metodologjia e vlerësimit e aplikuar bazohet në vlerësimin e shkallës së realizimit të aktiviteteve. Duke qenë se aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit shtrihen në tre faza, për qëllime të vlerësimit të ecurisë së realizimit të tyre është mbledhur dhe vlerësuar informacioni për secilin nga aktivitetet pavarësisht nga afatet e parashikuara të fillimit e përfundimit të tyre. Nga ky vlerësim rezultoi së një sërë aktiviteteve kishin filluar përpara kohës së parashikuar në dokumentin e Planit të Veprimit 2015-2020.

Bazuar në informacionin e mbledhur u realizua vlerësimi i ecurisë i cili mbajti parasysh vlerësimin e ecurisë bazuar në 2 kritere vlerësimi:

1. Vlerësimi të statusit të fillimit të aktivitetit: (i) nëse aktiviteti kishte filluar nga zbatimi i tij ; (ii) nëse aktiviteti nuk kishte filluar të zbatohet dhe (ii) nëse aktiviteti parashikohej të fillonte pas vitit 2016. Brënda kësaj kategorie u përfshin aktivitete të cilat sipas planit parashikoheshin të fillonin në vitet pas vitit 2016, ose parashikoheshin të fillonin në vitet 2015-2016, por që për arsye të caktuara fillimi i tyre ishte shtyrë për periudha të mëvonshme;


2. Shkalla e realizimit të aktivitetit: bazuar në këtë kritër aktivitetet të cilat kishin filluar të zbatoheshin u vlerësuan lidhur me shkallën e përmbushjës së tyre duke i klasifikuar në dy grupe: (i) të realizuara plotësisht dhe (ii) të realizuara pjesërisht.

Përfundimi i raportit dhe prezantimi i gjetjeve

SKNDQV 2015-2020 përcakton edhe kuadrin institucional të llogaridhënies dhe monitorimit të saj. Figura e mëposhtme përcakton sistemin institucional të llogaridhënies i parashikuar në strategji. Ky sistem parashikon Këshillin Konsultativ⁶⁵ si instrument të rëndësishëm për monitorimin dhe kordinimin e zbatimit të strategjisë. Mosngritja e Këshillit Konsultativ përbën një mangësi në këtë proces të monitorimit të zbatimit të strategjisë për këtë vit të parë të zbatimit të saj.

65. Këshilli Konsultativ do të jetë një strukturë permante e krijuar me akt nënligjor bazuar në ligjin organik të qeverisjes vendore. Këshilli Konsultativ në përbërje do të ketë përfaqësues të qeverisë në nivel ministrash, i drejtuar nga Ministri përgjegjës për çështjet vendore si dhe përfaqësues të qeverisjes vendore kryetarë bashkë të organizuar në shoqatat vendore të cilat do të përfshihen në rolin e sekretariatit teknik të këtij Këshilli. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë nga ky Këshill do të bëhet çdo vit dhe mbi bazën e raporteve të monitorimit, do të udhëzojë dhe rekomandojë marrjen e veprimeve konkrete për avancimin e zbatimit të strategjisë. Rekomandimet vjetore të Këshillit Konsultativ do tju bëhen të ditura Kuvendit, Qeverisë dhe donatorëve.

Figura 3: Kuadri Institucional i Llogaridhënies dhe Monitorimit



Drafti i parë i raportit përfundoi në fund të muajit Gusht 2016. Gjetjet kryesore të monitorimit u prezantuan në mbledhjen e Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Reformat në Administratën Publike, të mbajtur në 2 Shtator 2016.

Raporti i monitorimit do të bëhet publik dhe do të ndahet për informim nëpërmjet faqes së internetit të zyrës së Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore.

7 Statusi i Zbatimit sipas aktiviteteve te parashikuara ne Planin e Veprimit 2015-2020

Nr	Objektivat/Masat	Periudha e Zbatimit	Treguesit e Rezultatit (Produktet)	Progresi I Arritur	Hapat e Ardhshem	Institucioni
Qëllimi Strategjik I. Rritja e efikasitetit në tërësi të strukturave të qeverisjes vendore						
Objektivi Strategjik I.1 Reforma Administrativo-Territoriale						
Objektivi Specifik I.1.1		Konsolidimi administrativ dhe financiar i 61 bashkive të reja pas miratimit të ligjit të ri për ndarjen administrativo-territoriale;				
Treguesi i Performances		Indeksi i inventarizimit te aseteve				MCV
A	Ngritja dhe funksionimi i Agjencisë së Implementimit të Reformës Territoriale	2015-2020	VKM për ngritjen e Agjencisë së Implementimit të Reformës Territoriale	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 28.1.2015. Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale FZ. Nr. 14. 2015 fq. 548 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 18.3.2015. Për një shtesë në numrin e punonjësve dhe të fondeve buxhetore për Agjencinë e Zbatimit të Reformës Territoriale, për vitin 2015 Faqe 1919. Fletore Zyrtare Viti: 2015 – Numri: 45		MCV
			Nr. i personelit te emeruar	14 persona te emeruar. 800 persona kane marre pjese ne takimet e organizuara nga agjensia ne lidhje me funksionet e reja (ujitje, kullim , zjarrefiske, pyje dhe kullotat, arsim etj)		
B	Programi i mbështetjes infrastrukturore për 61 bashkitë e reja	2015-2020	Nr. i projekteve infrastrukturore për bashkitë e reja			MCV FZHR
C	Aplikimi i shërbimeve te integruara administrative me teknologji ICT per 61 bashkite dhe njesite administrative.	2015-2016	67 shërbime	Jane pilotuar shërbimet e reja te IT-se ne 5 bashki (Shkoder , Lezhe , Durres, Elbasan dhe Korce) dhe janë ngritur Zyrat e Integruara me një Ndalesë për ofrimin e shërbimeve në: (i) Bashkine Shkodër (aktualish jane dixhitalizuar 72 shërbime ne bashki dhe 2 njësi administrative),	Shtirirja ne njesite e tjera do te realizohet gjate vitit 2017 Gjate vitit 2016 sistemi do te zgjerohet ne Shkoder me 5 NjA, ne Lezhe me 2 NjA dhe do te filloje identifikimi i listes se shërbimeve ne Mat dhe Klos si dhe identifikimi isherbimeve qe duhet te ofrohen nga funksionet e reja. Ne vitin 2017 do te ngrihen OSSh-te ne	MCV, MIAP

				(ii) Bashkine Lezhë (aktualisht janë dixhitalizuar 83 shërbime në bashki dhe 2 NJA) dhe Vau i Dejes (aktualisht janë dixhitalizuar 62 shërbime në bashki dhe 1 NJA) (iii) Bashkine Korce (aktualisht janë dixhitalizuar 76 shërbime në bashki dhe 7 njësite administrative),	bashkine Mat dhe 7 Njësite, si dhe në Bashkine Klos dhe 4 NJA-te, do të përfundojë zgjerimi i sistemit në Shkodër, dhe do të zgjerohet në Lezhë dhe Vau i Dejes. Është në proces analiza e shërbimeve dhe përgatitjen e manualit të procedurave për Bashkitë: Fier dhe Berat - Në shtator-Tetor do të instalohet sistemi dhe do të fillojë puna në këto bashki duke përfshirë edhe Njësitë Administrative respektive. Gjithashtu janë parashikuar para Mars 2017 edhe Bashkitë Sarandë dhe Kucovë.	
Ç	Inventarizimi dhe konsolidimi financiar i 61 bashkive	2015-2016	- VKM për aprovimin e inventarit të pronave në 61 bashki.	Është aprovuar VKM 510 10 Qershor 2015 " Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativ-territorial http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/103-2015.pdf	Zyra e MCV do të kërkojë informacion nga të gjithë Njësitë për të raportuar se deri ku ka arritur procesi i marrjes në dorezim të pronave. Afati I raportimit do të jetë 31 Dhjetor 2016	MCV/
			- Raportet Financiare reflektojnë dhe marrjen e detyrimeve financiare nga bashkimi i Njësitë	Jane hartuar 373 raporte financiare të Njësitë dhe të konsoliduar në 61 bashkitë e reja. Raportet financiare janë vënë në dispozicion të Bashkive të reja dhe janë diskutuar me WWWB dhe IMF.	Raportet financiare do t'ju dërgohen zyrtarisht bashkive. Këto të fundit duhet të marrin masa për adresimin e rekomandimeve.	STAR
D	Përcaktimi gjeografik i kufijve administrative i 61 bashkive	2015-2016	Dokumenti ligjor që përcaktojnë kufijtë administrative të bashkive	Është hartuar draft VKM për përcaktimin e kufijve	Miratimi i VKM	MCV/ STAR
Objektivi Specifik I.2.2		Mbështetja institucionale dhe infrastrukturore për 12 qarqet dhe 61 bashkitë e reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.				
Treguesi i Performances		Treguesi i aplikimit të shërbimeve të integruara administrative nëpërmjet ICT				MCV
A	Hartimi i statuteve dhe rregulloreve model të 61 bashkive të reja	2015-2016	- Modeli i statutit të zhvilluar	Ligji i ri për qeverisjen vendore e ka shfuqizuar hartimin e statutit të bashkive.	Po përgatitet një draft statuti i ri dhe do të jepet 13 bashkive në fund të muajit Shtator. Nëpërmjet Shoqatës së Bashkive do shpërndahet edhe bashkive të tjera. Ky material do të jepet së bashku me një manual për sekretarët e këshillave bashkiak.	MCV

			- Model rregulloreje e hartuar	Eshte hartuar nje model e procedurave administrative për përdorim në sistemin e Zyrove të Integruara me Një ndalesë në Lezhë Shkodër, Vau i Dejës si dhe për Bashkinë Korçë.	Jane ne proces perfundimi manualetet e Bashkive Berat dhe Fier. Ne plan ato te Bashkive Sarande dhe Kucove. Do të zhvillohen rregulloret e procedurave administrative për përdorim në sistemin e Zyrove të Integruara me Një ndalesë në Mat dhe Klos.	
B	Asistenca teknike për administratoret e qytetit (menaxheri i qytetit) dhe administratoret lokal	2015-2018	323 administratorë lokalë të trajnuar	Ne Tetor 2015 eshte bere nje Trajnim Hyres me 323 administratoret e rinje, nepermjet 6 takimeve rajonale	Asistenca do vazhdoje ne vitet ne vijim nepermjet trajnimeve tematike	MCV
C	Hartimi i profileve të zhvillimit social-ekonomik	2015-2016	Programe zhvillimi te hartuara	Jane hartuar Programet Operacionale te zhvillimit per 26 bashki dhe Planet e Zhvillimit te Territorit nga per 36 bashki te tjetra. Jane zhvilluar Strategjitë Zhvillimit te Territorit për 10 Bashki: Durrës, Lezhë, Shijak, Dibër, Kukës, Elbasan, Fier, Lushnje, Kucove dhe Berat .	Ka filluar procesi i hartimit te Strategjive territoriale ne Bashkitë e Klosit, Matit dhe Tropojës dhe brenda vitit 2016 do të nisë procesi për hartimin e PPV të Bashkive Mat, Klos, Tropojë dhe Vau i Dejës, Elbasan, Fier, Lushnje, Kucove dhe Berat .	MCV/STAR
Ç	Asistencë për përgatitjen e buxheteve te konsoliduara dhe paketave fiskale te 61 bashkive.	2015-2018	61 bashki të trajnuara për buxhetet e konsoliduara	Ka nisur trainimi me 61 Bashki të vendit në Menaxhimin e Financave Publike. Trainimi një vjeçar me katër sesione, ka kurrikulen e dedikuar.	Aktualisht qeveria po harton kuaderrin e ri ligjor për financat vendore dhe me miratimin e ligjit do filloje hartimi I buxheteve te konsoliduara. Ketij procesi do ti paraprihet me hartimin e kurrikules se trajmit dhe programeve te trajnimit.	MCV,MF, NJQV
D	Asistencë për harmonizimin e Planeve të Zhvillimit te Territorit sipas ndarjes së re administrative	2015-2018	Udhëzuesi për hartimin	Hartuar nga AKPT. Programi Dldp ka hartuar Metodologjinë e Programit të Zonave Funkcionale, si dhe metodologjinë e kalimit nga PZF në Strategji të Territorit.	MZHU-ja dhe MSHCV do te shikojë mundesite ne periudhen 2017-2018 te harmonizimit te planeve te pergjithshme vendore ne 30 bashkite e tjera. Nga 27 të mbetura do mbështeten 8 deri 10 bashki, nga MZHU në vitin 2017 brenda financimit të parashikuar. Ka filluar procesi i hartimit te Strategjive territoriale ne Bashkitë e Klosit, Matit dhe Tropojës dhe brenda vitit 2016 do të nisë procesi për hartimin e PPV të Bashkive Mat, Klos, Tropojë dhe Vau i Dejës. Ka filluar gjithashtu procesi për hartimin e PPV të Bashkisë Malësi e Madhe. Janë mbajtur trajnime dhe do të mbahen në muajt në vazhdim për të trajnuar ekspertë të bashkive për hartimin e PPV dhe lidhjen e tyre me PBA	MCV, MZHU, AKPT
			Planet Vendore të zhvillimit dhe nr i bashkive të reja që asistohen për hartimin e planeve zhvillimi të territorit	31 planeve te pergjithshme vendore te harmonizuara te bashkive jane hartuar dhe do te miratohen brenda vitit 2016. (26 bashki po mbështeten tani nga MZHU; - 5 nga USAID (Elbasan, Berat, Fier, Kuçovë, Lushnjë); - 3 nga programi zvicerian i DLDP-së (Mali i Zi, Mati, Tropoja është lidhur kontrata);		
Objektivi Strategjik I.2 Strukturat Administrative						

Objektivi Specifik I.2.1		Forcimi i rolit vendimmarrës dhe monitorues të këshillave bashkiak dhe të këshillave të qarqeve				
Treguesi i Performances		Numri i nismave për politika publike dhe për monitorim e kontroll financiar dhe administrativ nga këshillat bashkiak.				MCV
A	Programi i trajnimit të këshilltarëve të rinj të 12 qarqeve dhe 61 bashkive	2015-2018	Të gjithë këshilltarët bashkiakë dhe të gjithë këshilltarët e qarqeve të trajnuar në 5 programe trajnimi	Jane zhvilluar aktivitete per ngritjen e kapaciteteve të grave këshilltare, përmes rrjetit të grave në politikë. Gjithashtu Raporti I Vleresimit te Nevojave per Trajnim ofron te dhena edhe mbi nevojat per trajnim te kryetareve dhe keshilltareve		MCV, Shoqatat Vendore, KiE
Objektivi Specifik I.2.2		Forcimi i rolit të kryetarëve të bashkive në menaxhimin e strukturave bashkiake dhe lidhshpimit				
Treguesi i Performances		% e ankesave/kerkesave te qytetareve ndaj vendimeve te keshillave bashkiak dhe strukturave te bashkise ne raport me numrin total te vendimeve.				NjQV, Monitorime nga Shoqeria Civile
A	Programi i lidhshpimit per kryetaret e rinj te 61 bashkive	2015-2018	61 kryetarë bashkie të trajnuar në programet e trajnimit per lidhshpimit	AZRTja ka zhvilluar disa takime informuese me kryetaret e rinj. VNT ofron te dhena edhe mbi nevojat per trajnim te kryetareve dhe keshilltareve	Ne 2016 do te filloje trajnimi I lidhshpimit me kryetaret e bashkive.	MCV, Shoqatat Vendore, KiE
B	Amendimi i Ligjit no. 8652/2000 Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal ", me qellim: (i) rritjen e fuqisë së kryetarit të bashkise për të miratuar strukturën organizative të administratës bashkiake si dhe rregulloren e brendshme të punës, dhe (ii) per krijimin e njesive administrative dhe percaktimin e funksioneve te tyre.	2015-2016	Ndryshimi i ligjit nr. 8652/2000 Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar dhe akteve nënligjore	Eshte miratuar ligji 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" qe ploteson parashikimet e kesaj mase		MCV, DAP
C	Programi i Transparencës dhe Pjesmarrjes ne vendimarrjen ne nivel vendor.	2015-2020	Numri i takimeve te keshillave bashkiake me pjesemarrje qytetare	Jane organizuar takimeve konsultimi ne disa bashki për ligjin pushtetit vendor (me keshilltarët bashkiake, drejtorite rajonale, shoqerine civile dhe ekspertet e bashkive). Komisione Keshillimore Qytetare jane institucionalizuara ne 13 njesi vendore, ku jane kryer procese konsultuese me qytetaret qe perfshijne tema te tilla si: PPV, paketen fiskale, Buxhetin etj	Ne vijim te raportit te vleresimit kombetar te transparences dhe llogaridhenies ne QV do te propozohet plani i ndihmes.	MCV,
				Po realizohet procesi I vleresimit kombetar te transparences dhe llogaridhenies ne QV.		

Objektivi Specifik I.2.3		Mbështetja për funksionalitetin e njësive administrative përbërëse.				
Treguesi Performances		Shkalla e transferimit të pronave vendore pranë NjQV-re				MB/MCV
Treguesi Performances		Raporti i projekteve të financuara me skemën PPP (numër)				MCV/MZHETTS
A	Zhvillimi i metodologjise për transferimin e funksioneve/kompetencave nga QQ në QV	2015-2016	Metodologjia për transferimin e funksioneve/kompetencave nga QQ në QV e hartuar	Është avancuar në përgatitjen e metodologjisë për transferimin e funksioneve. Është realizuar studimi lidhur me gadishmërinë e QV për të marrë funksionet e reja (është quajtur si monitorim i nivelit 2 - L2) si dhe po hartohen raporte për statusin e funksioneve të reja që janë transferuar pranë njësive vendore.	Do të vijohet gjatë 2016-2017 me monitorimin e nivelit L3 që nënkupton monitorimin se si QV ka ushtruar funksionet e transferuara. Pas këtij monitorimi do të finalizohet metodologjia për alokimin e funksioneve.	MCV,DLDP,Shoqatat Vendore
B	Vlerësim i detajuar i procedurave/proceseve të funksioneve aktuale dhe funksioneve të reja të planifikuara brenda mandatit të NjQV (përfshirë funksionet e reja menaxhuese).	2015-2016	Raporti i Vlerësimit i përfunduar	Janë analizuar shërbimet e QV që burojnë nga funksionet aktuale, si dhe një pjesë e shërbimeve që burojnë nga funksionet e reja. Analiza në kuadër të IOSSH	Pritet të hartohet në 2017.	MCV,Ministritë e linjës
C	Zhvillimi i standarteve lidhur me përcaktimin e numrit punonjësve dhe ngarkesën e punës për secilin funksion.	2015-2017	Raporti i standarteve të hartuara dhe të aprovuara	Janë zhvilluar standarte lidhur me strukturën organizative të Bashkive, nga pikëpamja e organizimit të shërbimeve në kuadër të IOSSH	Zgjerimi i eksperiencës në Bashki të tjera	DAP,MCV,
Ç	Vlerësimi/studimi i detajuar i mundësive për kontraktimin ose ofrimin e shërbimeve të përzgjedhura përmes partneritetit publik-privat.	2015-2018	Raporti i vlerësimit		Mbetet për tu bërë në vitin e ardhshëm	MCV,Ministritë e linjës, OJF
D	Përgatitja e modelit (blue print) për organizimin e administratës së bashkive të reja, si dhe një manual për zbatimin e tij.	2015-2016	Modeli dhe manuali të hartuara	Jane hartuar disa modele organigramash dhe manuali përkatës të cilat janë përdorur në më shumë se 30 bashki . kane përdorur keto modele. Dldp ka zhvilluar skema organizative në kuadër të ofrimit të shërbimeve përmes IOSSH Projekti I KiE ka ofruar dy modele strukturash njëri prej të cilëve është i ngarkuar në sistemin E-PAV për përdorim nga NJQV	Ne projektin STAR II keto modele do të përmiresohen me tej sipas specifikave të reja. Zgjerimi i eksperiencës në Bashki të tjera, duke përshtatur skemën organizative sipas tipologjive të ndryshme të Bashkive	DAP,Min. CV,STAR

DH	Përgatitja e modelit të përshkrimeve të punës / misionit për secilin prej njësisve tipike të administratës së bashkiakë për secilin funksion / proces kryesor, si dhe për secilin pozicion pune tipik të administratës së bashkiakë.	2015-2016	70% nga gjithë funksionet dhe detyrat me modele të përshkrimeve të punës të hartuara	Janë zhvilluar detyrat dhe përgjegjësitë e pozicioneve të punës në kuadër të ofrimit të shërbimeve përmes IOSSH (back-office dhe front-office). Eshtë miratuar Rregullorja Administrative	Zgjerimi i eksperiencës në Bashki të tjera, duke përshtatur rregulloren sipas tipologjive të ndryshme të Bashkive	DAP, MCV
E	Krijimi i një "help-desk-" të përhershëm dhe dhënie e ndihmës së vazhdueshme të bashkive në procesin e riorganizimit.	2015-2018	Numri i personave të punësuar në njësinë "Help-Desk" i ngritur DAP	Help-Desku është krijuar dhe funksionon pranë DAP-it, ku janë punësuar 2 eksperte për çeshtjet ligjore dhe teknike dhe një ekspert lokal tek ASPA për çeshtjet e trajnimeve.	Ne 2017 help-desku do të fuqizohet edhe për funksione/kompetenca të tjera.	MCV, DAP
Transferimi i Pronave						
A	Permbyllja e procesit të transferimit të pronave publike tek NJQV	2015-2020	VKM të nxjerra për miratimin e inventarit të pronave pronave për secilen nga bashkitë	Transferimi i pronave është stopuar në 2015. Në 2016 ka rifilluar procesin e transferimit në bashkitë e reja. VKM 63, datë 8.3.2016 ka kryer transferimin e 100% të pyjeve dhe kullotave të 61 bashkitë e reja, duke shfuqizuar mbi 300 VKM të meparshme për transferimin tek ish-komunat.		MPB, MCV
B	Krijimi i një sistemi të dixhitalizuar integral në nivel kombëtar dhe vendor për regjistrat e pronave të transferuara tek qeveria vendore	2015-2016	Sistemi digital i ngritur	Po kryhet një vlerësim për sistemin e regjistrimit të pronave bashkiakë nga OSBE-ja.	Raporti i vlerësimit do të dalë në 2016.	MPB, MCV
C	Zhvillimi i rregulloreve vendore për menaxhimin e aseteve të NJQV të reja.	2015-2017	Rregullorja e hartuar dhe miratuar	Eshtë hartuar një manual për zyrtarët vendor ku një kapitull i vecantë i referohet menaxhimit të aseteve vendore	Pas procesit të vlerësimit do të vlerësohen mundësitë e asistencës të bashkive për përgatitjen e këtyre rregulloreve.	MCV, MF, MPB, Shoqatat Vendore
Ç	Rishikimi i legjislacionit që rregullon procedurat për regjistrimin e të drejtës së pronës dhe menaxhimit të pronave bashkiakë ;	2015-2020	Ndryshimet ligjore në legjislacionin e pronave publike		Pas procesit të vlerësimit do të kemi rekomandimet konkrete për ndryshimet në legjislacion.	MD, MPB, MCV
Objektivi Specifik I.2.3		Forcimi i demokracisë lokale nëpërmjet rritjes së gjithpërfshirjes qytetare dhe forcimit të strukturave komunitare në nivel vendor.				
Treguesi Performances		Numri i strukturave qytetare në % kundrejt numrit të NJQV			NjQV, Monitorime nga Shoqeria Civile	
Treguesi i Performancës		Numri mesatar i takimeve të realizuara midis strukturave bashkiakë dhe strukturave			NjQV,	

		qytetare				Monitorime nga Shoqeria Civile
A	Mbeshtetja me infrastrukturen bashkekohore te vendimarrjes ne nivel vendor per promovimin e gjithethepershirjes qytetare dhe demokracise lokale (rikonstruksioni i sallave te keshillave bashkiake te bashkive te reja, pajisja me sistemet elektronike te votimit, ambjentet per pjesmarrjen e qytetareve/mediave ne punimet e keshillave).	2015-2020	Nr. i sallave te 55 keshillave bashkiake te rikonstruktuar	Nuk ka progres		MCV, donatore
B	Fuqizimi i strukturave komunitare ne nivel vendor (komisionet qytetare, kryetarët e fshatrave, ndërlihdhësit qytetar)	2015-2018	Nr i 61 bashkive të reja me struktura komunitare	Jane 2 projekte te mbeshtetura nga Leviz Albania dhe OSBE per krijimin e strukturave komunitare ne Tirane, Fier, Gjirokaster dhe Vau Dejes.		MCV,
				Me mbeshtjen e PLGP jane ngritur Komisione Keshellimore Qytetare te institucionalizuara ne 13 njesi vendore.		OJF
Objektivi Specifik I.2.5		Forcimi i dialogut midis qeverisë qendrore dhe qeverisë vendore, dhe llogaridhënies së dyanshme				
Treguesi Performances		Numri i tryezave të përbashkëta				Raportet e NjQV, Monitorimi i Shoqërisë Civile
Treguesi Performances		% e projektë vendimeve të marra me konsensus QQ/QV				Raportet e NjQV, Monitorimi i Shoqërisë Civile
A	Programi i forcimit te bashkepunimit qeveri qendrore-qeveri vendore. Ngritja e Keshilli Konsultativ dhe bashkepunimi me shoqatat vendore.		Keshilli Konsultativ i ngritur	Eshte pergatitur draftVKMja dhe jane bere konsultimet me shoqatat e bashkive.	VKM do te miratohet brenda 2016.	MCV, Shoqatat Vendore, Donoret
		2017-2020	Takimet me Shoqatat Vendore	Ky proces fillon pas ngritjes se keshillit.		
Qëllimi Strategjik II. Forcimi i Financave Vendore dhe Rritja e Autonomise Fiskale						
Objektivi Strategjik 1. Reformimi i sistemit të të ardhurave vendore						
Objektivi Specifik II.1		Rritja e kapacitetin e të ardhurave vendore të NJQV për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve;				
Treguesi i Performancës		Buxheti i Qeverisjes vendore në raport me PBB (%)				MF
Treguesi i Performancës		Raporti i të ardhurave vendore ne raport me PBB (%)				MF
A	Ngritja e grupit teknik të punës	2015-2016	- Grupi teknik i	Krijuar me ndihmen e projekteve PLGP		MCV, MF,

	me përfaqësues vendorë e qendrorë për të shqyrtuar dhe identifikuar fushat specifike të kuadrit aktual ligjor që ka nevojë të ndryshohet		punës i ngritur - Raporti mbi aktet nenligjore qe duhen rishikuar	dhe DLDP nen drejtimin e Ministrise se Financave. Pas miratimit te ligjit per financat vendore do te filloje procesi i hartimit te akteve nenligjore.		PLGP/USAIDShoqatat vendore
B	Hartimi i ligjit “Per Financat Vendore”	2015-2016	Ligji “Per Financat Vendore” i miratuar	Draftligji edhe pergatitur dhe eshte ne process konsultimi	Pritet te miratohet nga Kuvendi brenda vitit 2016.	MCV, MF, PLGP/USAIDShoqatat vendore
C	Rishikimi dhe miratimi i legjislacionit sektorial dhe akteve nenligjore per financat dhe taksat vendore	2015-2018	- Lista e legjislacionit sektorial e rishikuar	Pjese e procesit te grupit te punes sipas pikes A		MCV, MF, PLGP/USAIDShoqatat vendore
			- Lista e akteve nenligjore te rishikuara	Pas miratimit te ligjit per financat vendore do te filloje procesi I hartimit te akteve nenligjore. Eshte miratuar formula e re per grantin e pakushtezuar		
Ç	Analizimi i ndikimeve përhapëse të ndarjes së taksave kombëtare me NJQV-të	2015-2018	Raporti i analizës për ndryshimet e GDP/kapita ne nivel rajonal	Kryer pjeserisht nepermjet rekomandimeve te dokumentave politike dhe vleresimit te bere nga PLGP/USAID. Analiza mbetet per tu finalizuar gjate procesit te hartimit te ligjit per financat vendore.		MCV, MF, PLGP/USAID/Shoqatat vendore
D	Rritja e shpërndarjes së taksës së automjeteve në ndarje mes qeverisë qendrore dhe NJQV-ve	2015-2016	VKM per shperndarjen e takses e miratuar	Mbetet ne pritje pas miratimit te ligjit per financat vendore.		MCV, MF, PLGP/USAIDShoqatat vendore
DH	Zbatimi i sistemit të ri të taksës së pasurisë	2015-2018	Ndryshimet në legjislacionin në taksën e pasurisë	Mbetet ne pritje pas miratimit te ligjit per financat vendore. ose nje Ligji te ri Per Taksen e Pasurise -sipas rekomandimeve te FMN		MCV, MF, PLGP/USAIDShoqatat vendore
E	Mbeshtetje per administraten tatimore vendore per taksen e pasurise dhe taksat vendore	2015-2018	Nr i bashkive të asistuar në administrimin e taksave vendore nga programi PLGP	Eshte kryer. 12 Bashki partnere te PLGP/USAID dhe 2 jo partnere jane asistuar nepermjet "capacity building" workshops dhe "on the job trainings" dhe "demand-driven" asistence teknike PLGP - Sistemi I Administrimit te Taksave dhe Financave Vendore eshte implementuar ne 10 Bashki (Elbasan, Kamez, Vore, Lushnje, Berat, Kucove, Fier, Patos, Vlore dhe Sarande). Ne mungese te informacionit nga ZRPP per identifikimin e taksa paguesve te takses mbi pasurine		MCV, MF, PLGP/USAID/Shoqatat vendore

				per 5 bashki (Elbasan, Lushnje, Fier, Korce dhe Kamez) eshte ndertuar edhe nje sistem GIS.		
Objektivi Specifik II.2		Përmirësimi i qëndrueshmërisë, thjeshtësinë dhe barazinë e sistemit të transfertave së bashku me rritjen e transparencës				
Treguesi i Performances		Raporti i Transfertes se Kushtezuar kundrejt te Ardhurave Vendore (%)				MF
A	Krijimi i një formule të re transfertash për transfertat e pakushtëzuara bazuar në kriteret më transparente, më të thjeshta dhe më objektive	2015-2016	Formule e re e për transfertat e pakushtëzuara miratuar me VKM	Eshte kryer. Formula e re u miratua me ligjin 147/2015 'Per buxhetin e shtetit 2016'.		MF, MQV, NJQV
B	Përputhja e të dhënave nga Censusi dhe regjistri civil dhe përcaktimi i burimit të informacionit që do të përdoret për transfertat ndërqeveritare dhe për funksionet e shpenzimeve	2015-2016	Transferat për qeverisjen vendore përdorin një bazë të unifikuar të të dhënave të popullsisë	Eshte pjese e rëndesishme e formules se re te ndarjes se transfertes se pakushtezuar.		MPB, INSTAT, MF
C	Përdorimi i të dhënave të përputhura të popullsisë për qëllimin e bashkimit të NJQV-ve dhe për transfertat e grantit të pakushtëzuar	2015-2018	Transferat për qeverisjen vendore përdorin një bazë të unifikuar të të dhënave të popullsisë	Eshte pjese e rëndesishme e formules se re te ndarjes se transfertes se pakushtezuar.		MF, MCV, NJQV
D	Rishikimi i sistemit të granteve të kushtezuara (FZHR,etj) për ta fokusuar atë në zonat më rëndësi më të madhe rajonale; rishqyrtimi i saj në marrëdhënie me aftësitë dhe praktikat e nevojshme për thithjen e fondeve të BE-së në të ardhmen	2017-2018	Raport studimi për shpërndarjen e granteve të kushtezuara	Ky proces eshte ne shqyrtim nga grupi I punes per zhvillimin rajonal.		MF, MCV, NJQV
DH	Përcaktimi i nivelit të transfertave për qeverisjen vendore si përqindje e totalit të të ardhurave publike	2017-2018	Ndryshimi i legjislacionit për financat vendore	Do te miratohet si pjese e ligjit te ri per financat vendore.		MF, MCV, NJQV
Objektivi Specifik II.3		Rritja e kapaciteteve të NJQV që të përdorin huamarrjen dhe borxhin për financimin e investimeve kapitale, brenda politikave kombëtare të borxhit publik;				
Treguesi i Performances		Buxheti i Qeverisjes vendore në raport me PBB (%)				MF

A	Vlerësimi i kapacitetit të përgjithshëm për huamarrje nga qeverisja vendore dhe kufizimeve të vendosura ndaj NjQV për të marrë hua dhe për të përdorur kredi	2015-2016	Studimi i vlerësimit i përfunduar	Nuk ka progres.		MF, MQV
B	Krijimi i dialogut mes aktorëve kryesorë nga organizatat qendrore, vendore dhe financiare për të shqyrtuar kuadrin ekzistues ligjor dhe për të evidentuar përjasjet e reja ndaj huamarrjes	2016-2017	10 takime të zhvilluara	Mbetet në pritje pas miratimit të ligjit për financat vendore		MF, MQV, NJQV
C	Rishikimi i Ligjit për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore për të përcaktuar një raport më të drejtë të borxhit publike mes qeverisë qendrore dhe NJQV-ve	2017-2018	Ligji për Huamarrjen e Qeverisjes i rishikuar			MF, MQV, NJQV
Ç	Evidentimi i problemeve të kontabilitetit në nivel vendor dhe përgatitja e paketës së masave për trajtimin e tyre.	2017-2018	Raporti i vlerësimit i përfunduar			MF, MQV, NJQV
			Plani i Masave i Hartuar			
D	Asistenca për aplikimin e skemave të garantimit të huamarrjes vendore nepermjet lidhjes së tokës dhe infrastrukturës me autoritetet përkatëse të financimit.	2019-2020				MF, MQV, NJQV
			Nr i bashkive që përdorin instrumente të garantuara të huamarrjes vendore			
Objektivi Specifik II.4		Forcimi i sistemit të administrimit të financave publike në nivel vendor;				
Treguesi i Performances		% e borxheve të fshehura të identifikuar në nivelin vendor				MF, MCV, NJQV
Treguesi i Performances		% Njesive të Qeverisjes Vendore që adoptojnë qasjen PZHS dhe PBA (SDPeMTBP)				MF, MCV, NJQV
A	Identifikimi i borxheve të fshehura të krijuara para ndryshimit të hartës së NJQV-ve dhe hartimi i planeve specifike për mbulimin e borxheve	2015-2017	- Raporti mbi nivelin e borxheve të fshehura i hartuar	Eshtë hartuar raporti i borxheve dhe detyrimeve të prapambetura. Borxhi në fund të 2015 është 9,7 miliard leke.		MF, MCV, NJQV
			- Numri i planeve specifike i hartuar			
B	Zbatimi i Sistemit të kompjuterizuar të Informacionit Financiar të Thesarit në nivel vendor	2017-2018	- Numri i bashkive që kanë adoptuar 100 % sistemin e IFTh			MF, MQV, NJQV

C	Zgjerimi i reformës së Auditimit të Brendshëm dhe Kontrollit, Auditimit të jashtëm dhe Prokurimit Publik për të përfshirë pushtetin vendor; ngritja e nivelit të NJQV-ve në nivel po aq të rëndësishëm për monitorimin e performancës së progresit të reformave në fushën e MFP.	2017-2018	Nr i trajnuar i punonjësve të bashkive në fushën e menaxhimit financiar, auditit dhe prokurimit publik	Po trajnohen nga ASPA me ndihmen e DLDP për menaxhimin financiar në maj 2016 janë trajnuar 61 shefat e financave të bashkive.		MF, MCV, ASPA
						NJQV
